

Dëlirje & Edukim

GLSHT 2010 | SHABAN - RAMADAN 1431 | NR. 16 | QYMI 16

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE | KULTURORE SHKENCORE

XHELOZIA PËR SHENJAT E FESË

Në realitet, xhekozia në fjalë është pjesë e një parimi shumë thelbësor të besimit tonë, parimit të "mijëesë dhe amigjesë për Allahun", e cila është pjesë e shpërsë mësimin të besimtarëve. (q.2)

KË PO E PENGON
SHAMILA?

...dhe kështu, në ditë të njëjta, në mesin e pesë anëtarëve të shoqërisë, të cilët kishin pasionin për kërkimet shkencore, u ndodh një ngjarje e tillë që bëri që të gjithë të ndalojnë për një moment.



EDITORIALI

Zejd Haziri

Xhelozia për shenjat e fesë 2

Adem Avdiu

Kë po e pengon Shamia? 4

Xheladin Leka

Kush e dëshiron heqjen e shamisë? 6

Sabahudin Selimi

Vlera e mbulesës dhe efektet negative që vijnë nga heqja e saj në familje dhe shoqëri 8

Abdurrezak ibën Abdulmuhsin el-Bedr

Dobitë dhe vlerat e katër fjalëve 13

Seid Idris es-Selefij

Dyzet hadithe mbi metodologjinë e thirrjes pejgamberike 19

Zejd Haziri

Ngurtësia e zemrës 23

Unejs Murati

Pyetësori i përsosmërisë dhe suksesit 24

Zejd Haziri

Rregulla të rëndësishme në davet 26

Laura Ferati

Disa gabime në edukimin e fëmijëve (III) 29

Ali ibën Hasen el Halebi

Thirrje për vëllezërit dhe motrat e besimit për ardhjen e muajit të agjërimit 33

Abdulaziz ibën Baz

Vlera e agjërimit të Ramazanit dhe e namazit të teravisë si dhe sqarimi i disa dispozitave të cilat mund të mos i njohin disa njerëz 34

Namik Vehapi

Së pari duhet ofruar Islami 38

Kryeredaktor:

Zejd Haziri

Anëtarët e revistës:

Unejs Murati

Fidan Xhelili

Xheladin Leka

Bashkëpunëtorët:

Adem Avdiu

Muhamed Abdullahi

Sabahudin Selimi

Bali Sadiku

Lirim Sadiku

Namik Vehapi

Fehmi Dalipi

Shuajb Rexha

Redaktor gjuhësor:

Arian Koçi

Ballina & Dizajni:

Avni G. Gashi

Boton:

Shtëpia botuese

Atik

Gjilan, Republika e Kosovës

Tirazhi: 1000

Adresa:

Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan

Republika e Kosovës

Tel: 044 988 400

e-mail:

delirjedheedukim@gmail.com

Ndihmo Revistën:

Nr. i llog.: 1150-138922-0101-09

ProCredit Bank of Kosovo

Swift Code: MBKORS22

Gjilan, Republika e Kosovës

XHELOZIA PËR SHENJAT E FESË

Dijetari i madh es-Sa'di në tefsirin e tij për këtë ajet thotë: "Ai që madhëron shenjat e Allahut tregon se çfarë devotshmërie ka dhe tregon saktësinë e besimit të tij, sepse madhërimi i shenjave është tregues se ai madhëron Allahun dhe madhështinë e Tij."

Faja islame, të cilën Allahu na e ka bërë obligim ta praktikojmë, është një fe e përsosur, me të gjitha të mirat. Atë e bën edhe më të përsosur fakti se Allahu azze ve xhel-le jo vetëm që na ka ngarkuar me praktikimin e saj, por na ka obliguar edhe që ta mbrojmë atë dhe çdo shenjë madhështore të saj duke shfaqur xhelozin nëse njolloset ndonjë shenjë e fesë apo përbuzet ajo.

Bile xhelozia për shenjat e saj është parim themelor i besimit islam, pa të cilin besimi i besimtarit zbehet dhe mosprezenca e kësaj xhelozie shpeshherë mund të barazohet me dyfytirësi e hipokrizi.

Në lidhje me këtë parim esencial, Allahu i

Madhërishëm thotë: *"E kush madhëron shenjat e fesë së Allahut tregon, përkushtimin e zemrës së tij (dhe devotshmërinë më të madhe)."* Haxh 32

Dijetari i madh es-Sa'di në tefsirin e tij për këtë ajet thotë: "Ai që madhëron shenjat e Allahut tregon se çfarë devotshmërie ka dhe tregon saktësinë e besimit të tij, sepse madhërimi i shenjave është tregues se ai madhëron Allahun dhe madhështinë e Tij."

Prandaj sa herë që shenjat e fesë njollosen, përbuzen apo fyhen, pa marrë parasysh në çfarë metode, muslimani e ka për obligim që të ketë xhelozin ndaj këtij krimi karshi shenjave të Allahut, duke reaguar me urtësi, pjekuri e maturi,

se kështu tregon besimin e tij të pjekur thellë në zemër, tregon përkushtimin e zemrës së tij dhe devotshmërinë kulminante të saj.

Xhelozia e tij mund të shprehet në mënyra të ndryshme, mirëpo më e pakta që mund të bëhet është urrejtja e përbuzjes së shenjave të fesë me anë të zemrës. Dhe këtë e ka çdo besimtar që ka fare pak besim, e lëre më ai që jetën dhe çfarë posedon e ka sakrifikuar në ngritjen e shenjave të fesë së Allahut.

Në realitet, xhelozia në fjalë është pjesë e një parimi shumë thelbësor të besimit tonë, parimit të “miqësisë dhe armiqësisë për Allahun”, e cila është pjesë e shenjës së miqësimi të besimtarëve.

Për ta ilustruar më mirë këtë dhe njëkohësisht si argument të asaj që thamë për legjitimitetin e xhelozisë për shenjat e Allahut, po paraqes disa nga çështjet obligative të imanit për çdo besimtar, të cilat aludojnë se “miqësimi i besimtarëve” është realizuar.

1. Përkrahja e muslimanëve dhe të ndihmuarit e tyre me shpirt, pasuri dhe gjuhë në çështjet për të cilat ata kanë nevojë për ndihmë në fenë dhe dunjanë e tyre. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin.”*** Tevbe 71

2. Besimtari lëndohet në zemrën e tij kur dëgjon që një besimtar tjetër është lënduar dhe gëzohet kur një besimtar e kaplon një gëzim. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: ***“Shembulli i muslimanëve në dashurinë, lidhjen e tyre dhe mëshirën mes tyre është si shembulli i një trupi (me gjymtyrët e tij): nëse një gjymtyrë e trupit ankon, i tërë trupi sëmurët me dhembje dhe pagjumësi.”***

3. Këshillimi i ndërsjellë, t’ua duash atyre të mirën dhe të mos i mashtrosh. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: ***“Nuk ka besuar askush prej jush derisa mos të dojë për vëllanë atë që do për vete.”***

4. Besimtari është me besimtarët e tjerë në çdo vështirësi apo rehati, ndryshe nga hipokritët,

të cilët janë me besimtarët kur janë në rehati, ndërsa kur ka vështirësi dhe probleme, distancohen prej besimtarëve.

Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ata përgjojnë se çfarë do të bëhet me ju. Kështu, nëse ju vjen fitorja nga Allahu, ata thonë: ‘A nuk ishim vallë ne me ju?’ E, nëse mohuesit arrijnë fitore, hipokritët u thonë: ‘A thua nuk ju ndihmuam deri në fitore dhe ju mbrojtëm prej besimtarëve të vërtetë?’ Allahu do të gjykojë ndërmjet jush në Ditën e Kiametit. Allahu nuk do t’u japë kurrë rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët.”*** Nisa 141^[1]

Pra, ky është qëndrimi i çdo besimtari, kur ka tentativa për përbuzjen e shenjave të fesë së Allahut. Të gjithëve i dhemb ajo që i dhemb tjetrit dhe mërzhiten kur dikush brengoset për diçka. Nëse një besimtar apo besimtareje i cenohet një e drejtë, atëherë të gjithë duhet të brengosemi dhe ta shprehim brengën e xhelozinë tonë. Mirëpo, siç thamë, xhelozia duhet të shprehet me urtësi e maturi, duke pasur për qëllim përmirësimin e gjendjes kritike dhe jo përkeqësimin e saj, ngase besimtari i mençur gjithmonë është vizionar e largpamës, mundohet që me anë të xhelozisë së tij për shenjat e fesë të sjellë ngritjen e tyre e jo të bëhet shkakhtar që shprehja e xhelozisë të sjellë përbuzjen edhe të ndonjë shenje tjetër nga ata që nuk i çmojnë dhe nuk dinë t’i vlerësojnë për shkak të injorancës së tyre për vlerat e shenjave të Allahut.

Allahu na shtoftë xhelozinë ndaj shenjave të fesë islame dhe na bëftë të matur dhe largpamës gjatë urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja!

Kryeredaktori
Zejd Haziri

[1] Nga libri “El irshad...”, fq. 285, i dijetarit Salih el Fevzan

KË PO E PENGON SHAMIA?

Me këtë veprim institucionet përkrahin dekadencën dhe shthurjen morale si dhe propagandën skajshmërisht antiislame, që kohët e fundit ka pushtuar faqet e internetit dhe mediat.

Kohët e fundit shqiptarët muslimanë në Kosovë po diskriminohen, madje në mënyrë institucionale. Kjo situatë është shqetësuese dhe një mesazh për votuesit, që shtron përpara pyetjen se për kë kanë votuar deri tani. Situata aktuale që po na shoqëron na pasqyron një të kaluar jo të largët të monizmit, por tani me gëzofin e demokracisë, që më kujton thënien ujk me lëkurë qengji. Ndalimi i shamisë dhe lejimi i minifundeve e veshjeve provokuese në shkolla, të cilat nxisin pasione amoralosatani-zuese jo vetëm tek nxënësit por edhe tek mësimmdhënësit, sinjalizon diskriminim ndaj motrave muslimane, të cilat zbatojnë me dashuri e bindje parimin dhe urdhrin kur'anor- mbulesën fetare. Me këtë veprim institucionet përkrahin dekadencën dhe shthurjen morale si dhe propagandën skajshmërisht antiislame, që kohët e fundit ka pushtuar faqet e internetit dhe mediat. Kjo duhet të zgjojë ndërgjegjen, e cila bëhet pioniere për mbrojtjen e vlerave morale të shoqërisë tonë, të cilën e ka kapluar një mjegullinë e djal-



lëzuar që dërgon drejt një kulture skajshmërisht antihumane, aspak morale dhe tepër degjeneruese e siç shprehet populli, ujk do mjegull. Nuk është vetëm ndalimi i shamisë problemi që na shqetëson, pasi problemet kanë filluar edhe më herët, kurse ndalimi i shamisë është sinjal skajshmërisht i qartë se muslimanet po diskriminohen, prandaj kjo duhet të aktivizojë drejtësinë për të mbrojtur të drejtat fetare në jetën publike të popullatës shumicë muslimane në Republikën e Kosovës. Të mbrohen parimet fundamentale të fesë islame është domosdoshmëri që rrezaton Islamin autentik dhe jo “vehabizëm”, ashtu siç shprehen disa autorë në gazeta të përditshme. Ç’është më e keqja dhe që tregon naivitetin, arrogancën, idiotizmin e antiislamizmin e tyre, ata mundohen të na interpretojnë Islamin me injorancën dhe ideologjinë e tyre të satanizuar, me të cilën shprehin rrezikshmëri kundër muslimanëve si dhe thirrje për deislamizim më tepër sesa propaganda e Geert Wilderit. Në disa debate kundërshtarët e urdhrit kur'anor (shamisë) deklarojnë shumë lehtë e thjeshtë: “Nëse doni shami, hapni shkollat pri-

vate dhe vendosni rregullat tuaja, shkollat publike janë laike dhe jo fetare”. Së pari, kjo më kujton ekstremistin serb Sheshelin, kur në një debat për lejimin e shqiptarëve që të mësojnë në objektet shkollore pati deklaruar se nëse duan shqiptarët të shkollohen në objekte shkollore, atëherë le të ndërtojnë shkollat e tyre, por jo të shkollohen në objektet shkollore të shtetit tonë. Së dyti, në Republikën laike të Shqipërisë janë të mbrojtura femrat me shami dhe u lejohet shkollimi, kurse ata që i pengojnë gjobiten. Lind pyetja: Çfarë laicizmi na qenka ky i shtetit tonë të dashur, Kosovës, kur edhe Shqipëria është shtet laik?! Përgjigjja është më se e qartë. Kemi të bëjmë me njerëz që e urrejnë Islamit të cilët dëshirojnë deislamizimin e shoqërisë sonë. Kjo ndoshta ju duket e çuditshme, por do ta kuptoni shumë shpejtë e sidomos nëse i bëni vetes pyetjen se çfarë ka pas ndalimit të shamisë... Vallë mos po përsëritet historia e komunizmit sa i përket Islamit, ndërsa për besimet e tjera demokraci me standarde më të avancuara? A e meritojnë muslimanët këtë diskriminim e sidomos Bashkësia Islame e Kosovës, e cila po i shërben shtetit tonë në mënyrën më të mirë të mundshme, sidomos interesave të komunitetit musliman. Bashkësia Islame edhe në të kaluarën ka qenë në shërbim të popullit, veçanërisht në shërbim të Ministrisë së Arsimit, kur kësaj ministrie iu ndalua të zhvillonte mësimin në objektet shkollore. Ajo i shndërroi xhamitë në shkolla. Në medresenë Alaudin u mbajtën mbledhjet më të rëndësishme për çështjen kombëtare në kohën regjimit millosheviçian. Kjo kohë ende e shoqëron popullin tonë me kujtime rrëqethëse, emocionale e presione psikike. Sa e sa hoxhallarë dhanë jetën për hir të Zotit në luftën e Kosovës?! Si sot më kujtohet lajmi që dëgjova në TVSH për heroizmin e hoxhë Januz Zejnullahut, Zoti e mëshiroftë, i cilësuar si Mic Sokoli, që viktimizoi triumfalisht snajperistët serb në istikamen e tyre dhe ra heroikisht! Sa xhami u dogjën e u shkatërruan nga okupatori serb?! Vallë e meritojmë diskriminimin?! A nuk është diskriminim që në kryeqytetin e shtetit tonë muslimanët falen në rrugë

e trotuare në mungesë të një qendre islamike, për shkak se nuk lejohet të ndërtohet, kurse në anën tjetër ndërtohet katedralja për një përqindje shumë të vogël besimtarësh katolikë, për të cilët ekziston kisha ku mund t'i kryejnë ritualet fetare?! Nuk ka dyshim se kjo ndihmon prishjen e tolerancës ndërfetare dhe njëkohësisht ekstremizmin katolik, i cili po funksionon nën propagandën e rrejshme të tolerancës, demokracisë e laicizmit. Në realitet ata me këto veprime po e kundërshtojnë laicizmin e pretenduar. Nëse një femre që zbaton urdhrin kur'anor mbulesën fetare i ndalohet shkollimi për shkak se ajo me atë shami propagandon Islamit në një objekt që është publik, atëherë si do t'i përgjigjen popullit që logjikon e gjykon drejt këta që i kanë shndërruar sheshet e qyteteve të Kosovës në simbole të katolicizmit duke ndërtuar përmendore të Gonxhe Bojaxhiut?! Ajo i shërbeu katolicizmit dhe jo vendit e kombit. Me shprehjen jo vendit mendoj se jam i qartë me lexuesin, ngase Gonxhe Bojaxhiu nuk i shërbeu katolicizmit në vendin e vet, por katolicizmit në Kalkutë. Në fund, motrat të cilat zbatojnë urdhrin kur'anor për t'u mbuluar shfaqin kulturën dhe civilizimin hyjnor dhe jo atë arab. Edhe nënat shqiptare muslimane në të kaluarën ishin me mbulesa fetare, por atë ua largoi me dhunë komunizmi i egër. Disa prej tyre u burgosën dhe u keqtrajtuan. As mjekra nuk është simbol i binladenianëve terroristë, por është urdhër fetar që ka qenë i njohur edhe tek stërgjyshërit tanë kur atëherë “Usama bin Ladeni” nuk ka ekzistuar fare. Prej stërgjyshërve tanë kishte që dhënë jetën për këtë fe, siç ishte rasti i Lugut të Baranit, ku brohoritjet e fundit të shqiptarëve para Savë Batares, i cili i ekzekutoi barbarisht, ishin duam xhami e nuk duam kishë. Kjo ngjarje e paharruar reflekton sloganin nuk flijohet jeta për fenë që është pranuar me dhunë, por për atë që është pranuar me dëshirë e bindje.

Adem Avdiu

KUSH E DËSHIRON HEQJEN E SHAMISË ?

Kurse ibën Kethiri thotë: “Fjala e Allahut “por ata që jepen pas epsheve dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë” do të thotë se pasuesit e dajave nga radhët e çifutëve, të krishterëve dhe lavirëve dëshirojnë që të largoheni nga e vërteta në të kotën, me një largim të plotë.”

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili i dha secilit atë që meriton. Përsëritet qofshin mbi Muhamedin, të dashurin e Allahut, i cili e barti amanetin e Allahut me përpikëri, ishte udhëzues për gjithë njerëzimin, përgëzues për të gjitha mirësitë dhe begatitë dhe qortues për të gjitha gjërat e këqija dhe të dëmshme për individin dhe shoqërinë.

Allahu dëshiron që njeriu të pendohet tek Ai, të pendohet për veprat e këqija që ka vepruar dhe të mos bëhet pesimist ndaj mëshirës së Allahut dhe në të njëjtën kohë të mos i përsërisë mëkatet. Kurse ata të cilët jepen pas epsheve dëshirojnë që muslimani të largohet nga rruga e drejtë krejtësisht, në mënyrë që shokët e tij të shtohen, rruga e së keqes të zgjerohet dhe kështu të bëhet më e lehtë për të ecja në këtë humnerë të sigurt. Allahu thotë: *“Allahu dëshiron që t’jua pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”* Nisa 27

Po a thua kush janë këta që “jepen pas epsheve”?

Ibën Xheriri, Allahu e mëshiroftë, thotë se “është thënë se këta janë lavirët, por thuhet gjithashtu se ata janë çifutët dhe të krishterët”,^[1] ndërsa imam Kurtubiu thotë: “Kanë rënë në mospajtim dijetarët në lidhje me përcaktimin e atyre që pasojnë epshtet (që janë përmendur në këtë ajet). Muxhahidi thotë se ata janë lavirët, kurse Suddiju thotë se ata janë çifutët dhe të krishterët. Disa dijetarë thonë se qëllimi janë veçanërisht çifutët, ngase ata kanë tentuar që muslimanët t’i pasojnë ata në martesën me motrat që i kanë pasur vetëm nga babai.”^[2] Ndërsa Ibën Zejdi thotë: “Ky ajet është i përgjithshëm (d.m.th. përfshin lavirët, çifutët, të krishterët etj.) dhe këtë mendim e përkrah edhe Kurtubiu, Allahu e mëshiroftë.”^[3]

Të njëjtin mendim ka edhe imam Taberiu dhe ibën Kethiri. Imam Taberiu thotë: “Allahu i ka përshkruar këta njerëz se ata jepen pas epsheve të tyre të neveritshme dhe nëse çështja qenka kështu, atëherë kuptimi i parë i këtij ajeti është ai kuptim që shfaqet sipërfaqësisht dhe jo ndonjë kuptim i brendshëm për të cilin nuk

[1] Shiko tefsirin e Taberiu të komentimi i këtij ajeti, “Xhamiul Bejan” (6/621).

[2] Pra, të çifutët është e lejuar të martohesh me vajzën të cilën e ke motër vetëm nga babai dhe jo nga nëna, kurse një vepër e tillë është e ndaluar në Islam.

[3] Shiko tefsirin e Kurtubit gjatë komentimit të këtij ajeti, “El xhami’ li ahkamil Kur’an” (5/154).

dëshmon ndonjë argument apo analogji. E, nëse është kështu, atëherë në këtë ajet “të cilët jepen pas epsheve” bëjnë pjesë çifutët, të krishterët, lavirët dhe çdo pasues i së kotës, ngase çdo pasues i asaj që ka ndaluar Allahu është pasues i epshit të tij. E pasi çështja është kështu, atëherë komentimi që ë bëme këtij ajeti patjetër është komentimi primar dhe i saktë.[4]” Kurse ibën Kethiri thotë: “Fjala e Allahut “por ata që jepen pas epsheve dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë” do të thotë se pasuesit e djajve nga radhët e çifutëve, të krishterëve dhe lavirëve dëshirojnë që të largoheni nga e vërteta në të kotën, me një largim të plotë.[5]”

Dijetari i madh bashkëkohor Abdurrahman es-Sa’di, Allahu e mëshiroftë, gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: “Fjala e Allahut “ata që jepen pas epsheve” domethënë se anojnë nga shkojnë epshet dhe u japin përparësi epsheve në mënyrë që ta kënaqen, madje i adhurojnë epshet e tyre. Këta njerëz janë mosbesimtarët dhe mëkatarët, të cilët u japin përparësi epsheve të tyre ndaj respektimit të Allahut. Këta njerëz dëshirojnë “që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë”, d.m.th. të devijoni nga rruga e drejtë dhe të shkoni në rrugën e atyre me të cilët Allahu është i hidhëruar dhe në rrugën e të humburve. Këta njerëz dëshirojnë që t’ju largojnë nga respektimi i të Mëshirshmit, që të respektoni shejtanin e mallkuar, t’ju largojnë nga përkushtimi ndaj urdhrave të Allahut, e cila është e gjithë lumturia, që të pasoni atë që ju sjell vetëm mjerim. Nëse e kuptuat që Allahu ju thërret në atë që është në të mirën tuaj, në atë që është shpëtim dhe lumturi dhe këta të cilët jepen pas epsheve ju thërrasin në atë që është humbje dhe mjerim i thellë, atëherë merreni në konsideratë thirrjen më të mirë dhe zgjidhni rrugën më të mirë nga këto dy rrugë.[6]”

Nga këto fjalë të dijetarëve gjatë komentimit

të këtij ajeti të madh u bë e qartë se kë po e pengon shamia dhe kush mundohet ta heqë atë. Personat të cilët nuk njohin udhëzimin, ata që e kanë humbur dritën në mesin e ditës, ata çdoherë do të jenë kundër çdo iniciative të përmirësimit të kësaj shoqërie, ngase përmirësimi është fitim i madh për popullin, mirëpo humbje e madhe për ata të cilët ecin pas epsheve të tyre.

Është shumë logjike që ata mundohen ta ndalojnë shaminë, ngase kështu i sigurojnë vetes dhe epsheve të tyre atë që dëshirojnë, përndryshe nuk do të kishin mundësi të luanin me vajzat e reja e të ndershme. E, dihet shumë mirë se mbulesa simbolizon nderin.

Por ata nuk mjaftohen me kaq. Ata dëshirojnë, siç na tregoi Allahu në këtë ajet, që edhe ne të bëhemi si ata, në mënyrë që të gjithë të jemi njësoj në punë të pista djallëzore dhe të gjithë të jemi në gradën e kafshëve apo edhe më ulët. Për të arritur këto qëllime, ata mundohen të shfaqin çdo të keqe dhe amoralitet në popull, ndërkohë që me mish dhe shpirt luftojnë çdo të mirë dhe nder. Këta janë ata që kanë luajtur dhe akoma luajnë me qenie njerëzore dhe këta janë ata të cilët trafikojnë motrat tona. Këta janë shkaku kryesor i përhapjes së Sidës dhe sëmundjeve të tjera në këtë popull. Po ashtu këta janë ata të cilët luftojnë çdo nder dhe çdo gjë që e ruan atë. Motra ime, shamia është nder për ty dhe për gjithë popullin, kurse lakuriqësia është mjerim për këtë botë para botës tjetër. Lakuriqësia lë pasoja të rënda në veten tënde dhe në shoqëri. Pa e zgjatur më shumë, motër e nderuar, dije që metoda më e mirë për t’u dhënë atyre mundësi që t’i pasojnë epshet je ti dhe përmes teje ata arrijnë çdo fëlliqësi që sillet në kokat e tyre, prandaj mos u bëj pre e ujkut të pangopur.

Allahu na mjafton, sa ndihmës i mirë është Ai!

Xheladin Leka

[4] “Xhamiul Bejan” (6/624).

[5] “Tefsirul Kur’anil Adhim” (1/624).

[6] “Tejsirul Kerimirr-Rahman fi tefsiril kelimil Mennan” (fq. 163) gjatë komentimit të këtij ajeti.



VLERA E MBULESËS DHE EFEKTET NEGATIVE QË VIJNË NGA HEQJA E SAJ NË FAMILJE DHE SHOQËRI

Mbulesa bën thirrje për pastrimin e zemrave të besimtarëve dhe i mbush ato me devotshmëri, i bën ato që t'i urrejnë mëkatet. Ajo që ka thënë Allahu i Lartësuar është e vërtetë: “...E kur kërkonit prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre...”

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut të Lartësuar. Përshëndetjet tona qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të sinqertë dhe mbi gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit. Allahu i Lartësuar ua bëri obligim mbulesën (shaminë) grave të besimtarëve, të

cilat e adhurojnë Allahun duke e mbuluar tërë trupin dhe bukuritë e tij para burrave të huaj për to. Ky është një adhurim për të cilin shpërblehet nga Allahu kush e praktikon, ndërkohë që ndëshkohet kush e lë dhe nuk e praktikon. Për këtë arsye, lënia e mbulesës është nga mëkatet e mëdha dhe i tërheq të tjerët në mëkate të mëdha. P.sh. kur një femër zbulon një pjesë nga trupi i saj, qëndron

me meshkuj dhe i tërheq ata, si pasojë e mosmbajtjes së mbulesës vijnë mëkate të tjera.

Është obligim për çdo femër besimtare që t'i përgjigjet dhe ta respektojë atë që Allahu i Lartësuar e bëri obligim ndaj tyre, të vendosin shamitë, të mbulojnë trupin, të jenë të pastra nga punët e liga dhe të kenë turp (marre), duke iu bindur Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Tij sal-Allahu alejhi ve sel-lem. Allahu Fuqiplotë thotë: "Kur Allahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës."^[1]

Si mund të lihet mbulesa kur pas obligueshmërisë së saj ka urtësi e fshehtësi të mëdha dhe të shumta, virtyte të lavdëruara, qëllime dhe mirësi të mëdha. Prej tyre janë edhe këto:

1. Ruan nderin: Mbulesa është shkaku kryesor në ruajtjen e nderit, largimit të dyshimeve, provokimeve (fitneve) dhe shthurjeve në shoqëri.

2. Pastron zemrën: Mbulesa bën thirrje për pastrimin e zemrave të besimtarëve dhe i mbush ato me devotshmëri, i bën ato që t'i urrejnë mëkatet. Ajo që ka thënë Allahu i Lartësuar është e vërtetë: *"...E kur kërkon prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas*

perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre..."^[2]

3. Ngre moralin: Mbulesa fton në ruajtjen e normave më të larta morale, në ruajtjen e pastërtisë shpirtërore, modestisë, turpits, xhelozisë dhe në anën tjetër ndalon nga poshtërsitë skandaloze siç janë humbja e dinjitetit, imoraliteti, poshtërimi dhe degjenerimi etj.

4. Është shenjë e maturisë, ndershmërisë: Mbulesa është shenjë shariatike që tregon ndershmërinë, maturinë, dinjitetin, bujarinë e tyre dhe në të kundërtën i distancon ato nga dyshimi, ofendimi dhe pasiguria, siç thotë Allahu i Lartësuar: *"O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve le t'i vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është Mëshirues."*^[3] Të pamurit e mirë nga jashtë është argument se edhe mbrendësia është e mirë. Vërtetë maturia, vetpërmbytja është kurora e gruas, në atë shtëpi që valvitë ndershmëria dhe maturia gjithmonë në të do të ketë lumturi.

5. Ndërpret lakminë dhe intrigat e shejtanit: Mbulesa e mbron shoqërinë nga punët e liga, nga sëmundja e zemrave^[4] të burrave dhe grave, është pengesë e lakmisë që të shpie në imoralitet (prostitucion), ndërpret shikimin e syve mashtrues, mbron nderin e burrit, të gruas dhe të të tjerëve. Është mburojë nga shpifjet

[1] Ahzab, 36.

[2] Ahzab, 53.

[3] Ahzab, 59.

[4] Qëllimi janë sëmundjet që vijnë nga mëkatet.

dhe fjalët e liga që u bëhen grave të devotshme e të ndershme, nga poshtërsitë e dyshimit dhe të pasigurisë dhe është mburojë nga shumë mashtrime të tjera të shejtanit të mallkuar.

6. Ruan turpin: Turpi është pjesë e jetës, nuk ka jetë pa të. Është një moral i lartë që Allahu i Lartësuar e vendos tek ata persona që dëshiron t'i nderojë. Ua dhuron atë njerëzve me vlerë dhe e largon atë nga fytyrat e të pandershmëve. Turpi është nga veçoritë e njeriut, nga virtytet e natyrshmërisë dhe moral islam. Turpi është një nga pjesët e besimit (imanit). Turpi ishte një nga veçoritë më të famshme të arabëve, të cilën Islami e vërtetoi dhe bëri thirrje në të. Mef'uli ka thënë: "Turpi të bën të stolisesh më të mira, të ndalon nga të këqijat. Turpi e ndalon njeriun të bëjë punë të liga. Mbulesa nuk është tjetër vetëm se një mjet i përsosur për mbrojtjen e turpit. Heqja e mbulesës njëherazi është edhe heqja e turpit."

7. Pengon ndikimin e lakuriqësisë dhe shfrenimin e shoqërisë: Mbulesa pengon përzierjen e burrave dhe të grave në shoqëritë islame.

8. Është mbrojtje nga prostitucioni dhe imoraliteti: Gruaja me mbulesë nuk do të jetë pre e çdo rrugaçi.

9. Gruaja është e tëra avret:^[5] Shamia është mbulesë për të dhe të mbuluarit pa dyshim që vjen nga devotshmëria. Allahu

i Lartësuar thotë: *"O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues. Po petku i devotshmërisë, ai është më i miri."*^[6]

Abdurr-Rahman ibën Eslemi, Allahu e mëshiroftë, në komentimin e këtij ajeti ka thënë: "E ka frikë Allahun dhe i mbulon ato pjesë të trupit që i ka të ndaluara t'i zbulojë, e ky është petku i devotshmërisë." Gjithashtu në lutjen e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka ardhur: "O Allahu im, m'i mbulo të metat e mia dhe më bëj të sigurt në qasjet e frikshme!"^[7]

10. Mbulesa ruan xhelozinë.

Efektet negative që vijnë nga heqja e mbulesës

1. Heqja e mbulesës është mëkat nga mëkatet e mëdha ndaj Allahut të Lartësuar dhe mosrespektim i urdhrave të të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe s'ka dyshim se mëkatet ndaj Allahut dhe mospasimi i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të shpijnë në humnerën e xhehennemit, Allahu na ruajttë nga dënimi i tij. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"I gjithë ummeti im do të hyjë në xhennet, përveç atij që refuzon."* Të pranishmit i thanë: *"O i Dërguari i Allahut, e kush refuzon (të hyjë në xhennet)?"* Ai tha: *"Kush më pason mua, do të hyjë në xhennet e kush më kundërshton mua, vetëm se ka refuzuar."*^[8]

2. Heqja e mbulesës sjell mallkimin dhe

[4] Qëllimi janë sëmundjet që vijnë nga mëkatet.

[5] Çdo pjesë të trupit e ka të ndaluar ta zbulojë para burrave të huaj, me përjashtim të shuplakave të duarve dhe të fytyrës.

[6] Araf, 26.

[7] "Sahih Sunen" i Ebi Davudit 5074, i saktë (sahih).

[8] Trans Buhariu 7280.

largimin nga mëshira e Allahut: Transmetohet nga Abdullah ibën Amër, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Në fund të këtij ummeti (para kiametit), do të jenë disa burra që hipin mbi shala^[9] derisa të vijnë te dyert e xhamive. Gratë e tyre janë të veshura por të zhveshura (gjysmëlakuriqe apo veshin rroba të tejdukshme), kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta. Mallkojini ato se ato me të vërtetë janë të mallkuara...”*

3. Heqja e mbulesës është nga cilësitë e banorëve të xhehennemit. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Dy grupe njerëzish prej banorëve të zjarrit akoma nuk i kam parë: disa burra që (me vete) mbajnë shkopinj si bishatat e lopëve dhe me ta i rrahin njerëzit dhe gra që janë të veshura por të zhveshura (gjysmëlakuriqe, apo veshin rroba të tejdukshme), të pandershme (mëkatore) dhe që i shpien të tjerët në mëkate, kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta. Nuk kanë për të hyrë në xhennet dhe nuk do ta shijojnë aromën e tij, edhe pse ajo ndihet nga një largësi e madhe.”*^[10]

4. Heqja e mbulesës është dyfytirësi (nifak) dhe errësirë në Ditën e Kiametit: I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“...Gratë më të këqija janë të zhveshurat (gjysmëlakuriqe) mendjelarta, ato janë dyfytirëshe (munafike), e rralla prej tyre që do të hyjë në xhennet.”*^[11]

5. Heqja e mbulesës sjell shthurje dhe imoralitet në familje dhe shoqëri: I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Për tre persona as që pyetët...”, e ndër ta përmendi edhe “...një grua që burrin e saj nuk e ka afër dhe ka nga të mirat e dunjasë i mjaftojnë (për të jetuar), e pastaj zbulon trupin e saj (për t'i tërhequr meshkujt e tjerë)...”*^[12]

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na tregoi për këtë kategori grash që presin që burrat e tyre të largohen nga shtëpia dhe të shkojnë me të tjerë, por si është halli me gratë në kohën që po jetojmë, të cilat nuk e presin as këtë, por duke qenë burri prezent në shtëpi e bëjnë një gjë të tillë, zbukurohen dhe dalin gjysmëlakuriqe.

6. Heqja e mbulesës është thirrje e shejtanit të mallkuar: Pasi vënia e mbulesës ose e shamisë është pasim i urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, atëherë heqja e saj nuk është tjetër vetëm se realizim i thirrjes së shejtanit të mallkuar sepse ai fton gjithmonë në të kundërtën e asaj që Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kanë ftuar. Allahu i Lartësuar thotë: *“(Iblisi) Tha: “Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde (në rrugën e Allahut) të drejtë, mandej do t'u sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre*

[9] Shala që vendoset përmbi kafshën e cila shërben si mjet udhëtimi, si p.sh. mbi kalë, deve etj.

[10] Trans Muslimi 2128.

[11] Trans Bejhëkiu në “Sunen el-Kubra” 13256, i saktë (sahih). Shiko librin “Sahih el-Xhamius-Sagir” 3330.

[12] Trans Imam Ahmedi 23943, i saktë (sahih). Shiko librin “Sahih el-Xhamius-Sagir” 3058.

nuk do ta gjesh që të falënderojnë (të besojnë)!” ^[13]

Pasi shejtani i mallkuar ishte dhe do të jetë armiku ynë i përbetuar, që na largon nga rruga e drejtë, nga rruga që Allahu dhe i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na porositi, Allahu i Lartësuar na e përmendi në Kur'an ngjarjen e babait dhe nënës së njerëzimit (Ademit alejhi selam dhe Havës), duke na porositur që të mos biem pre e kurtheve të shejtanit ashtu si ranë ata. Allahu i Lartësuar thotë: *“O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojë kurrësi shejtani sikurse i nxori prindërit tuaj nga xhenneti, zhveshi prej tyre petkun e tyre që t’ju dalë në shesh lakuriqësia e tyre. Vërtet ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk i shihni. Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë.”* ^[14]

7. Heqja e mbulesës është shkaku kryesor i përhapjes së prostitucionit: Si rezultat i heqjes së saj janë përhapur shumë cilësi negative në familje dhe shoqëri, si humbja e moralit, e turpit, shfaqja e prostitucionit, imoralitetit, largimi i të rinjve nga martesë e ligjshme, mosinteresimi i prindërve për fëmijët e tyre, shtimi i aborteve, përhapja e shumë sëmundjeve vdekjeprurëse si Sida etj. Të gjitha këto, e shumë të tjera që nuk i përmendëm, janë rezultat i heqjes së shamisë duke e zëvendësuar atë me veshje gjysmëlakuriqe siç ne po shohim sot. Këto tërmete, vërshime, përmbytje, trazira që po përjetojmë në kohën tonë nuk janë

tjetër vetëm se dënim nga ana e Allahut të Lartësuar për shkak të përhapjes së punëve të liga. Allahu i Lartësuar thotë: *“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat).”* ^[15]

Duhet të kenë kujdes ata që bëhen shkaktarë që imoraliteti të marrë hov në familje dhe shoqëri sepse Allahu i Lartësuar do t'i dënojë ata në këtë dhe botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë: *“Ata të cilët dëshirojnë që të besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhimbshëm në këtë dhe në botën tjetër. Allahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini.”* ^[16]

Nuk na mbetet tjetër vetëm se të punojmë deri në maksimum për të mirën e familjes dhe shoqërisë sonë dhe njëkohësisht ta lusim Allahun e Lartësuar me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të larta që të na ndihmojnë në përmirësimin e vetes dhe të të tjerëve nga çdo ves dhe cilësi e shëmtuar.

*Përmbledhi dhe përshtati
Sabahudin Selimi*

[13] A'raf, 16-17.

[14] A'raf, 27.

[15] Rrum 41

[16] Nur, 19.



DOBITË DHE VLERAT E KATËR FJALËVE

"SUBHANALLAH", "ELHAMDULILAH",
"LA ILAHE IL-LALLAH", "ALLAHU EKBER"

Transmeton Imam Muslimi në "Sahihun" e tij prej hadithit të Ebu Hurejrës radijallahu anhu, i cili thotë: "Ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Sikur të them subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallah, Allahu akber, është më e dashur për mua sesa dunjaja dhe çfarë ka në të."

Falënderimet qofshin për Allahun, Zotin e botëve. Salatet dhe selamet qofshin për imamin e Pejgamberëve, Muhamedin, për familjen dhe për shokët e tij.

Me të vërtetë Allahu azze ve xhel-le i ka veçuar katër fjalë me dobi të mëdha, që tregojnë për rëndësinë dhe pozitën e lartë të tyre. Këto fjalë veçohen nga fjalët e tjera:

SUBHANALLAH (i pa të meta, i lartësuar je o Allah),

ELHAMDULILAH (falënderimet të takojnë Ty o Allah),

LA ILAHE IL-LALLAH (nuk ka kush që meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut),

ALLAHU EKBER (Allahu është më i madhi).

Janë transmetuar argumente të shumta

që tregojnë rëndësinë e madhe që kanë këto fjalë dhe çfarë shpërblimesh të mëdha ka në praktikimin e tyre, dobi të shumta, të mira e të vazhdueshme në këtë botë dhe në botën tjetër.

E kam parë të arsyeshme që t'i grupoj disa prej tyre në një vend, pasi në esencë janë pjesë prej librit tim "Fikhu El-Edijeti Vel Edhkar", por dëshira e disa vëllezërve ishte që t'i veçoja këto dobi në një libërth të veçantë në mënyrë që të përfitojnë njerëzit dhe të shtohen të mirat, me emrin e Allahut. Vëlla i dashur musliman, ja këto dobi, medito për to me qetësi dhe pa u ngutur, se ndoshta do të gjesh diçka që ngjall ndjenjat, ripërtërin nijetin dhe vendosmërinë dhe ndihmon në ruajtjen e këtyre fjalëve. Allahu është ndihmëtar për çdo të mirë dhe nuk ka ndihmë dhe largim prej së keqes vetëm se me ndihmën dhe vullnetin e Tij.

1 Prej dobive të këtyre fjalëve është se këto fjalë janë fjalët më të dashura për Allahun.

Transmeton Muslimi në "Sahihun" e tij nga Semurete ibën Xhundubi, radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Fjalët më të dashura për Allahun janë katër, nuk prish punë se me cilën prej tyre fillon së pari: subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallahu, allahu ekber."*^[1]

Ebu Davud et-Tajalisij në "Musnedin"

e tij transmeton: "Katër janë prej fjalëve më të mira, e ato janë prej Kur'anit, nuk ka gjë të keqe me cilëndo të fillosh: subhanallah, elhamdulilah, la ilahe ilallahu, allahu ekber."^[2]

2 Prej dobive të tyre është se na ka lajmëruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ato janë më të dashura për Allahun se dunjaja dhe çfarë ka në të.

Transmeton Imam Muslimi në "Sahihun" e tij prej hadithit të Ebu Hurejrës radijallahu anhu, i cili thotë: *"Ka thënë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: 'Sikur të them subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallah, Allahu akber, është më e dashur për mua sesa dunjaja dhe çfarë ka në të.'"*^[3]

3 Prej dobive të tyre është ajo që është vërtetuar në "Musnedin" e Imam Ahmedit dhe në "Shuabul Iman" të Bejhakiut me isnad të mirë nga Asim ibën Behdeleh, e ky nga Ebu Salih, e ky nga Ummu Han'I bint Ebi Talib, e cila ka thënë: *"Ka kaluar pranë meje Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe i thashë: 'Unë me të vërtetë jam e shtyrë në moshë dhe jam dobësuar. Më urdhëro me ndonjë punë të cilën e kryej duke qenë ulur.' Më tha: 'Lartësoje Allahun (thuj Subhanallah) njëqind herë, se kjo është e barabartë me lirim të njëqind robërve prej pasardhësve të Ismailit. Falënderoj Allahun (thuj Elhamdulilah) njëqind*

[1] "Sahih Muslim", nr: 2137.

[2] "Musned et-Tajalisij", fq. 122.

[3] "Sahih Muslim", nr: 2695.

herë, është sikur të përgatitësh njëqind kuaj mirë për në luftë në rrugën e Allahut. Madhëroje Allahun (thua Allahu ekber) njëqind herë, është e barabartë me njëqind kurbane të shënuar dhe të pranuar. Thuaj La ilahe il-lAllah njëqind herë...”, ka thënë ibën Halefi, transmetuesi nga Asimi, më duket se ka thënë: “...mbushet (me të mira) sa gjerësia mes qiellit dhe tokës dhe se nuk do të vijë askush me punë më të mira në



Ditën e Kiametit përveç atij që vepron si ti.”^[4]

Mundhirit thotë: "E ka transmetuar Ahmedi me zinxhir-isnad të mirë."^[5]

Dhe e ka cilësuar këtë hadith si të mirë dijetari i madh Albani rahimehullah.^[6]

Pra, paramendoje këtë shpërblim të madh për këto fjalë. Kush e madhëron Allahun njëqind herë, është e barabartë me lirim të njëqind robërve prej pasardhësve të Ismailit. Janë përmendur pasardhësit e Ismailit ngase janë prej arabëve me prejardhje më me vlerë.

Kush thotë elhamdulillah, e falënderon Allahun njëqind herë, është sikur të ketë përgatitur si sadaka njëqind kuaj me frerë dhe shalë, të përgatitur për muxhahidinët në rrugën e Allahut.

Kush e madhëron Allahun, thotë Allahu ekber njëqind herë, është si të japë sadaka njëqind kurbane prej deveve të shënuara.

E, kush thotë la Ilahe il-lAllah njëqind herë, ato do ta mbushin çfarë ka mes qiellit dhe tokës e nuk do të vijë askush me punë më të mira në Ditën e Kiametit përveç atij që vepron si ky.

4 Prej dobive të këtyre fjalëve është se ato janë shlyese për mëkatet. Është vërtetuar në “Musned” dhe në “Sunenin” e Tirmidhiut, në “Mustedrekun” e Hakimit, nga Abdullah ibën Amër ibën el-Asi radijAllahu anhu, se ka thënë: “Ka thënë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi

[4] "El-Musned" (6/344) dhe "Shuabul Iman", nr: 612.

[5] "Et-Tergibu ve et-Terhib" (2/409).

[6] "Es-Silsiletu es-Sahihah" (3/303).

ve sel-lem: "Nuk ka në sipërfaqen e tokës njeri që thotë la ilahe il-lallahu, allahu ekber, subhanallah, elhamdulillah, ve la havle ve la kuvete il-la bilah, vetëm se i janë shlyer atij mëkatet, edhe nëse janë të shumta sikurse shkuma e detit."

Tirmidhiu ka thënë se hadithi është i mirë.

Hakimi ka thënë se është i saktë, është pajtuar me të edhe Dhehebiu.

Edhe Albani këtë hadith e ka cilësuar si të mirë.^[7]

Me mëkatet e falura në këtë hadith nënkuptohen mëkatet e vogla, ngase është vërtetuar në "Sahihun" e Muslimit, nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma, Ramazani deri në Ramazan shlyejnë mëkatet e vogla, nëse shmangen ato të mëdha."*^[8]

Pra, falja e gjynaheve të vogla është e lidhur ngushtë me largimin, shmangien nga mëkatet e mëdha, ngase mëkatet e mëdha falen vetëm me pendim.

Në këtë kuptim është edhe hadithi të cilin e transmeton Tirmidhiu dhe të tjerët nga Enes ibën Maliku radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka kaluar pranë një pemë së cilës i ishin tharë gjethet dhe e goditi atë me shkopin e tij, saqë gjethet e saj ranë në tokë. Atëherë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"Me të*

vërtetë (elhamdulillah) falënderimi ndaj Allahut, subhanallah (lavdërimi i Allahut dhe pastrimi i Tij nga çdo e keqe që i atribuohet), la ilahe il-lallah (të dëshmuarit se nuk ka kush që meriton adhurim përveç Allahut), Allahu ekber (madhërimi i Allahut), largojnë mëkatet e robit siç ranë gjethet e kësaj peme."

Albani hadithin e ka cilësuar si të mirë.^[9]

5 Prej dobive të këtyre fjalëve është se ato janë mbjellja e xhenetit. Transmeton Tirmidhiu nga Abdullah ibën Mesudi radijAllahu anhu, e ky prej Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ka thënë: *"Kam takuar Ibrahimin alejhi selam natën e Israsë e më tha: "O Muhamed! Transmetoja ummetit tënd prej meje selamin dhe lajmëroji ata se xhenneti është vend me tokë të mirë, me ujë të ëmbël, ajo është "KIAAN", të mbjellat e tij janë subhanallah, elhamdulillah, la ilahe il-lallah, vallahu akber."* Në isnadin e këtij hadithi është Abdurrahman ibën Is'haku, por për vërtetësinë e këtij hadithi dëshmojnë dy hadithe të tjera, hadithi i Rbu Ejjub el-Ensarit dhe hadithi i Abdullah ibën Umerit.

Shprehja "el-kiaan" është shumësi i "kaun", që është vend i rrafshët dhe i gjerë, sipër së cilës është uji i qiellit, bie mbi të dhe rriten bimët e saj.^[10]

Qëllim me këtë hadith është se në

[7] "El-Musned" (2/158, 210), "Sunen et-Tirmidhi" (nr: 3460), "Mustedrek el-Hakim" (1/503) dhe "Sahihu el-Xhami" (nr: 5636).

[8] "Sahih Muslim", nr: 233.

[9] "Sunen et-Tirmidhi" (nr. 3533), "Sahih el-Xhami" (nr: 1601).

[10] "En-nihajeh fi garibi el-hadith" (4/132).

xhennet rriten shpejt të mbjellat me këto fjalë sikurse mbijnë të mbjellat e tokës pjellore dhe bimët e saj.

6Prej dobive të tyre është se nuk ka askush vlerë më të madhe për Allahun sesa besimtari i cili është jetëgjatë dhe me Islam, i cili e shpreshton përsëritjen e këtyre fjalëve (Allahu ekber, subhanallah, la ilahe il-Allah, elhamdulilah).

Transmeton Imam Ahmedi dhe Nesaiu në librin "Amelu el-Jevmi ve el-Lejle" me isnad të mirë nga Abdullah ibën Shidadi, se një grup prej tre personash nga beni Udhreh erdhën te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe pranuar Islamin.

Thotë-Abdullahu: *"Ka thënë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Kush po i merr nën kujdesin e tij?" Talha tha: "Unë." Thotë: "Kanë qëndruar te Talha përderisa Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i dërgoi disa shokë të tij në një betejë. Me ta shkoi edhe njeri prej tyre dhe u vra në atë betejë.*

Më vonë ka dërguar disa shokë në një betejë tjetër, në të cilën shkoi edhe një tjetër prej tyre. Edhe ai u vra.

Ndërsa i treti vdiq në shtratin e tij.

Thotë Talha: *"I kam parë që të tre në xhennet."*^[11] *Kam parë atë që vdiq në shtratin e tij para tyre, kam parë atë që vdiq i fundit pas tij, ndërsa atë që vdiq i pari e pashë të fundit. Më çuditi kjo dhe*

shkova te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe e pyeta për këtë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem më tha: "Çfarë të bëri të çuditësh, nuk ka më të dashur për Allahun sesa ai jetëgjatë me Islam, i cili e shpreshton tekbirin e tij (madhërimin e Allahut), tesbihun e tij (pastrimin e Tij prej çdo të mete që i atribuohet), tehlilin e tij (dëshminë se nuk ka kush që meriton të adhurohet përveç Allahut) dhe tahmidin e tij (falënderimin e Allahut)." ^[12]

Ky hadith na jep të kuptojmë vlerën e madhe që ka ai person i cili jeton shumë dhe punon vepra të mira dhe gjuha e të cilit vazhdon të jetë e lagur me përkujtimin (dhikrin) e Allahut azze ve xhel-le.

7Prej dobive të këtyre fjalëve është se Allahu I ka veçuar dhe zgjedhur këto fjalë për robërit e Tij dhe ka përgatitur për atë që i përsërit këto fjalë shpërblime (sevape) të mëdha dhe të shumta. Është transmetuar në "Musnedin" e Ahmedit dhe "Mustdrekun" e Hakimit nga hadithi I Ebu Hurejrës dhe Ebu Saidit radijAllahu anhumas, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë Allahu i ka zgjedhur katër fjalë: subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallah, Allahu akber. Kush thotë subhanallah, i shkruhen njëzet të mira dhe i shlyhen njëzet të këqija. Kush thotë Allahu ekber gjitha-*

[11] I ka parë në ëndërr (sh.p).

[12] "El-Musned" (1/163), "Sunenu el-Kubra" të Nesaiut, "Kitab amelu el-jevmi ve el-lejleh" (6/nr: 10674).

Ndërsa Albani hadithin e ka cilësuar si të mirë, "Silsiletu es-Sahihah", nr: 654.

shtu. *Kush thotë la ilahe il-lallah gjithashtu. E, kush thotë elhamdulilah prej vetvetes së tij, i shkruhen atij tridhjetë të mira dhe i shlyhen tridhjetë të këqija.*"^[13] Në këtë hadith shihet se nëse robi falënderon Allahun, sevapet janë më të mëdha, pra nëse robi e thotë atë nga vetvetja e tij, ngase falënderimi nuk bëhet vetëm si rrjedhojë apo pas ndonjë shkakut, si pas ngrënies apo pirjes apo ndonjë të mire çfarëdo qoftë ajo, si të ishte shpagim i asaj që i është dhënë atij, mirëpo atëherë kur robi falënderon prej vetvetes së tij pa e nxitur atë ndonjë shkak apo ripërtëritje e ndonjë të mire, i shtohen shpërblimet e tij.

8. Prej dobive të këtyre fjalëve janë se shërbejnë si mburojë për pronarin e tyre nga zjarri i xhehennemit dhe vijnë në Ditën e Kiametit si shpëtimtare për pronarin e tyre dhe i paraprijnë atij.

Transmeton Hakimi në "Mustedrekun" e tij dhe Nesaiu në "Amelu el-jevmi ve el-lejle" dhe të tjerët prej Ebu Hurejrës radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Merreni mburojën tuaj."* I thamë: *"O i Dërguari I Allahut, prej armikut?"* Tha: *"Jo, por mburojën tuaj nga zjarri. Thoni subhanallah, velhamdulilah, la ilahe il-lallah, vallahu ekber, ngase ato vijnë në Ditën e Kiametit si shpëtimtare dhe paraprirëse dhe janë të mbeturat e mira (fryti i të cilave është i*

përrjetshëm)."

Thotë Hakimi: "Hadithi është i saktë sipas kushtit të Muslimit, edhe pse nuk e transmetojnë asnjëri- Buhariu dhe Muslimi."

Dhehebiu është pajtuar me një gjykim të tillë.

Edhe Albani e ka cilësuar si të saktë.^[14]

Si shtesë nga hadithet e kaluara, ky hadith cilëson se këto fjalë janë "të mirat e mbetura". Thotë Allahu në Kur'an:

"...kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përrjetshëm), janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë." Kehf 46

Të mbeturat e mira janë ato vepra të cilat mbeten dhe u vazhdon shpërblimi. Kjo është shpresa më e mirë e njeriut, por gjithashtu edhe shpërblimi (sevapi) më i mirë.

Vijon

Shkëputur nga libri:

"Fadailu el-Kelimat el-Erbea, Subhanallah, velhamdulilah, ve la ilahe il-lallah, vAllahu ekber"

Autor: Abdurrezak ibën Abdulmuhsin el-Bedr

Përshtati: Bali Musli Sadiku

[13] "El-Musned" (2/302), "el-Mustedrek" (1/512), ndërsa Albani hadithin e ka cilësuar si të saktë, "Sahihu el-Xhami", nr: 1718.

[14] "El-Mustedrek" (1/541), "es-Sunenu el-Kubra", "Kitab Amelu el-Jevmi ve el-Lejleh" (6/212) dhe "Sahihu el-Xhami" nr: 3214.



DYZET HADITHET

MBI METODOLOGJINË E THIRRJES PEJGAMBERIKE

"Çifutët janë ndarë në shtatëdhjetë e një grupe dhe janë ndarë të krishterët në shtatëdhjetë e dy grupe, kurse ummeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjithë do të jenë në zjarr përveç njërit." Ata thanë: "Cili grup është ai, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "Ai është xhemati."

HADITHI I PARË

Sinqueriteti

Transmetohet nga Umer ibën Hat-tabi radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Pa dyshim që veprat nuk konsiderohen të mira vetëm se me qëllime (të mira) dhe sigurisht se çdo njeri nuk do të shpërblehet ndryshe veçse sipas qëllimit. Andaj, kushdo që kur emigron, emigron (me qëllim) për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, emigrimi*

i tij (do t'i llogaritet) për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Kurse kushdo që me emigrimin e tij ka për qëllim arritjen e diçkaje nga kjo botë apo martesën e një gruaje, ai nga emigrimi i tij nuk do të arrijë veçse atë që ka pasur për qëllim."

Transmetojnë Buhariu (1) dhe (54), Muslimi (1907), Ebu Davudi (2201), Tirmidhiu (1647), Nesaiu (75) dhe Ibën Maxheh (4227).

HADITHI I DYTË

Uniteti i burimit të marrjes së mësimave

Transmetohet nga Ibni Abbasi radijaAllahu anhu, se ka thënë: "Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në Haxhin Lamtumirës u ligjëroi njerëzve duke u thënë: "O ju njerëz (vini re)! Pa dyshim që unë ju kam lënë juve dy gjëra, nëse kapeni për to, kurrë nuk do të lajthitni: (ato të dyja janë) Libri i Allahut dhe Sunneti im."

Hadith sahih, e ka nxjerrë Hakimi (1/93), Bejhakui në "Es-Sunen el-Kubra" (10/114) dhe në "Delailu en-Nubuvveh" (5/449), Ibni Hazmi në "El-Ihkam" (6/809) dhe e ka vlerësuar si autentik, Ibni Nasër në "Es-Sunne" fq. 21 dhe e ka vlerësuar si autentik edhe muhadithi Imam Albani në "Sahihu et-Tergib vet-Terhib" (40).

HADITHI I TRETË

Uniteti i burimit të të kuptuarit

Së pari: Kuptimi i hulefai rrashidinëve

Transmetohet nga Irbad ibën Sarijeh radijAllahu anhu, se ka thënë: "Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem njëherë na këshilloi me një këshillë prekëse, që drodhi zemrat dhe derdhi lotin. Ne i thamë: "O i Dërguar i Allahut! Kjo këshillë sikur të ishte këshilla e një lamtumirësi (dikush që bëhet gati për udhëtim apo është në prag të vdekjes), kështu që na porosit me diçka."

Ai tha: "Ju porosis që t'ia keni frikën Allahut, të bindeni dhe të jeni të nënshtruar edhe nëse juve ju caktohet si udhëheqës një rob habeshij. Dhe dijeni se kush prej jush të jetojë në të ardhmen, do të shohë kundërshtime të shumta, prandaj kapuni për Sunnetin tim dhe sunnetin e hulefai rrashidinëve udhërrëfyes, shtrëngohuni për to si me dhëmballë dhe kini kujdes nga gjërat e shpikura sepse çdo bidat është devijim."

Në një transmetim: "Dhe çdo devijim të çon në zjarr."

Transmetimin e parë e ka nxjerrë Ebu Davudi (4607), Tirmidhiu (2676), Ibni Maxheh (43, 44) dhe shejh Albani rahimehullah e ka vlerësuar si autentik në "Es-Sahiha" (2735).

Kurse të dytin e ka nxjerrë Nesaiu (1578), Bejhakui në "El-Esmau ves-Sifat" (137) me sened autentik, siç gjendet në "El-Exhivetu en-Nafiah" fq. 55.

HADITHI I KATËRT

Së dyti: Bazamenti është Sunneti i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe sunneti i hulefai rrashidinëve

Transmetohet nga Hudhejfe ibën Jemani radijAllahu anhu, se ka thënë: "Njerëzit e pyetnin Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për hajrin, kurse unë e pyetja për sherrin nga frika se do të bjerë në të. Kështu që thashë: "O i Dërguar i Allahut, ne ishim në një injorancë dhe sherr, pastaj Allahu na solli këtë të mirë (hajr), e a thua a do të ketë pas këtij hajri sherr?"

Ai tha: "Po."

Unë i thashë: "E, a ka pas këtij sherri hajr?"

Ai tha: "Po, por me Dehan."

I thashë: "E çështë Dehani i saj?"

Ai tha: "Një popull që pasojnë sunnet tjetër nga sunneti im dhe nuk marrin për udhëzim udhëzimin tim, tek ta shihni vepra që kundërshtojnë (sheriati) dhe aso që janë prej tij."

Unë i thashë: "E, a ka këtij hajri sherr?"

Ai tha: "Po, thirrës në dyer të xhehennemit, kush u përgjigjet atyre në këto dyer, ata e fusin në to."

I thashë: "O i Dërguar i Allahut, na i përshkruaj ata."

Ai tha: "Po, njerëz prej lëkurës sonë dhe flasin me gjuhët tona."

Unë i thashë: "Me çfarë po më këshillon, nëse i arrij ata?"

Ai tha: "Mbahu te xhemati i muslimanëve dhe imami i tyre."

Unë i thashë: "E nëse ata nuk kanë as xhemat e as imam?"

Ai tha: "Atëherë largohu nga të gjitha ato grupime, qoftë edhe nëse detyrohesh të kapesh te trangu i një druri derisa të të zërë vdekja ashtu."

Transmetojnë Buhariu (4084), Muslimi (1847), Ebu Avaneh (7166) dhe Ibën Maxheh (3979).

HADITHI I PESTË

Së treti: Kuptimi i sahabëve në tërësi

Transmetohet nga Avfi bin Maliku radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Çifutët janë ndarë në shtatëdhjetë e

një grupe dhe janë ndarë të krishterët në shtatëdhjetë e dy grupe, kurse ummeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjithë do të jenë në zjarr përveç njërit."

Ata thanë: "Cili grup është ai, o i Dërguar i Allahut?"

Ai tha: "Ai është xhemati."

Në një transmetim tjetër: "Kush qëndron në atë që jam unë dhe shokët e mi."

Kurse në një transmetim tjetër: "Ata janë sevadul-eadhëm."

Gjuhësisht fjala sevad e ka burimin nga fjala esved, që do të thotë e zezë, kurse sevad do të thotë grumbull njerëzish në një vend dhe nëse shikohen nga larg, duken si diçka e madhe e zezë. Ndërsa "el-eadhëm" do të më e madhja, pra një grumbull i madh njerëzish.

Mirëpo në hadith me të është për qëllim xhemati i cituar në transmetimin e parë, pra kushdo që ndjek Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe shokët e tij me të mirë konsiderohet prej xhematit.

Kjo është miratuar edhe nga dijetarët muslimanë, si Axhurri në "Esh-Sheriah" (1/125), Imam Shatibiu në "El-I'atizam" (2/267), Lalekaiu në "Sherhu Usuli I'atikadu Ehklus-sunneti vel-xhema'ah" (1/25), Ibën Tejmije në "Mexhmu'ul-Fetava" (3/345) dhe shumë të tjerë.

Transmetimin e parë e ka nxjerrë Ibën Maxheh (2992), Ibën Ebi Asim në "Es-Sunneh" (63), Lalekaiu (149) dhe hadithi është hasen.

Kurse të dytin e ka nxjerrë Tirmidhiu (2641), Hakimi (1/128-129), Axhuriu në "Sheriah" (16) dhe Lalekaiu (147) dhe hadithi është hasen.

Kurse të tretin e ka nxjerrë Ibën Ebi Asim në es-Sunneh (68), Ibën Nasër në "Es-Sunneh" fq. 16-17 dhe Lalekaiu (151-152) dhe hadithi është hasen.

HADITHI I GJASHTË

Së katërti: Udhëzimi i katër shekujve të artë

Transmetohet nga Imran ibën Husajn radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Më të mirët e ummetit tim janë njerëzit e shekullit tim, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas këtyre (Imrani tha: "Nuk e di pas shekullit të tij e përmendi dy herë apo tri), më pas jush do të jenë disa njerëz që janë të ngutshëm në dëshmi, por janë anashkalues të dëshmisë, tradhtojnë dhe nuk janë të besueshëm, zotohen por nuk e çojnë në vend atë dhe tek ata paraqitet trashësia e tepërt."*

Në një transmetim nga Nu'aman ibën Beshiri radijAllahu anhu, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit më të mirë janë shoqëruesit e mi, pastaj ata të cilët pasojnë shoqëruesit e mi, pastaj ata të cilët pasojnë pasuesit e shoqëruesve të mi, pastaj vijnë disa njerëz, të cilët dëshmia e ndonjërit prej tyre ia kalon betimit të tij ose betimi i tij dëshmisë së tij."*

Me fjalën "disa njerëz" është për qëllim qortimi, pra njerëz që dallojnë nga njerëzit e mirë të shekujve të artë.

Kurse fjala "dëshmia e tij ia kalon betimit të tij" ka për qëllim se ata janë të ngutshëm në dëshmi, por nuk e ruajnë atë.

Transmetimin e parë të këtij hadithi e transmetojnë Buhariu (2651) dhe Muslimi (2535),

kurse të dytin e transmetojnë Ahmedi (3594), Ibën Hibbani në "Eth-Thikat" (8/1), Ibën Ebi Shejbeh në "El-Musannef" (12460) dhe shtojcën e shekullit të katërt e ka vlerësuar si të saktë Ibën Kajjimi në "I'alamul-Muvekki'in" (2/9).

Burimi: "El-erbeune hadithen nebevije..."

Zgjedhi: Seid Idris es-Selefi

Përshtati: Zejd Haziri

Ngurtësia e zemrës

Nuk është ndëshkuar njeriu me ndëshkim më të madh sesa ngurtësia e zemrës dhe largimi nga Allahu.

Zjarri është krijuar për shkrirjen e zemrave të ngurta.

Zemra më e largët nga Allahu është zemra e ngurtë.

Kur zemra ngurtësohet, syri nuk loton.

Ngurtësimi i zemrës vjen nga katër gjëra, nëse kalohet kufiri i tyre:

1- ushqimi... 2- gjumi... 3- të folurit... 4- përzierja me njerëz.

Ashtu si trupit kur sëmuret nuk i bën dobi as ushqimi e as të pirët, edhe zemrës kur sëmuret nuk i bëjnë dobi këshillat.

Kush dëshiron të ketë zemër të pastër, atëherë le të ndikojë Allahu në epshin e tij.

Zemrat e lidhura me epshe janë të penguara nga Allahu, aq sa janë të lidhura me to.

Ai që për vendqëndrim të zemrës së tij cakton Allahun, ai është qetësuar dhe është rehatuar.

Kurse kush zemrën e tij ua jep njerëzve, ai nuk është i qetë dhe brenga e tij vetëm se do të shtohet. Shërimi i zemrës është me pendim dhe vepra. Ajo gjithashtu ndryshket ashtu siç ndryshket hekuri, zbardhja e saj është me dhikër (të përmendurit e Allahut).

Ajo edhe zhvishet ashtu siç zhvishet trupi, kurse dekorimi i saj është devotshmëria. Ajo ka uri dhe etje ashtu si trupi, ushqimi dhe pija për të janë: të mbështeturit në Allahun, dashuria ndaj Tij dhe kthimi tek Ai.

Zemra ka gjashtë stacione, nëpër të cilat lëviz:

tre prej tyre janë poshtëruese për të, kurse tre të tjera e ngrenë lart.

Poshtërueset janë:

1- dunjaja që i zbukurohet asaj,

2- nëfsi që lakmon

3- dhe armiku (shejtani) që i bën cytje asaj.

Këto pra janë tre stacionet e ulëta e nënçmuese nëpër të cilat qarkullon.

Kurse tre të tjerat që e ngrenë atë janë:

1- dija që i shpjegohet,

2- mendja që e udhëzon,


3- dhe Allahu, të Cilin e adhuron.

Pra, zemrat qarkullojnë nëpër këto stacione...".

(Përzgjedhje nga fjalët e Ibën Kajimit rreth zemrës)

Burimi: www.kulalsalafiyen.com

Zgjidhni dhe përshtati: Zejâ' Haziri



PYETËSORI I PËRSOSMËRISË DHE SUKSESIT

Suksesi që synon besimtari përfshin tri gjëra: jetën e kësaj bote, jetën në varr dhe jetën në ahiret.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Përfundimi i mirë u takon të devotshmëve. Nuk ka armiqësi vetëm se ndaj të padrejtëve. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi krijesën më të ndritshme, Pejgamberin tonë Muhamedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mbi shokët dhe mbi të gjithë pasuesit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Të gjithë kërkojnë suksesin.

Të gjithë kërkojnë përsosmërinë.

Të gjithë kërkojnë të jenë të dalluar dhe vrapojnë drejt më së mirës.

E dimë që fillimi është një pikë, por edhe e

kundërta, zjarri i madh fillon nga një gacë. Pra, suksesi është në hap... E cili është hapi drejt suksesit?

Pa dyshim se hapi i parë drejt suksesit është të kuptojmë se çfarë do të thotë sukses.

A është sukses në shkollë? A është sukses në profesion? A është sukses në pasuri? A është sukses në post dhe personalitet? A është sukses në marrëdhënie të përgjithshme? A është sukses njohja e gjuhëve të huaja dhe traditat e vendeve të huaja? A është sukses njohja e teknologjisë bashkëkohore? Për të gjitha këto përpiqen njerëzit e madje shumë prej tyre

mendojnë me të vërtetë se sukses do të thotë arritja e të gjitha këtyre apo e disave prej tyre. Mirëpo realiteti i tyre të drejton vetëm drejt një pjese të suksesit që e dëshirojnë njerëzit e dijes dhe të mendjes.

Suksesi që synon besimtari përfshin tri gjëra: jetën e kësaj bote, jetën në varr dhe jetën në ahiret.

BAZAT E SUKSESIT

Suksesi ka baza dhe paragrafë që njihen si baza ose paragrafë të suksesit. Kush është praktikuesi më i mirë i tyre pa dyshim se do jetë edhe më i suksesshmi, ndërsa kush është neglizhent dhe anashkalues i tyre do të jetë më afër dështimit dhe larg suksesit.

Në vazhdim do t'i paraqesim disa nga këta paragrafë shkurtimisht:

1. Besoji Allahut Fuqiplotë me besim të pastër dhe të fortë, duke kërkuar çdo herë nga Ai për të gjitha çështjet e tua.

2. Kujdesu në kryerjen e obligimeve të tua ndaj Allahut, duke mos lënë asnjë; gjithçka ta bësh me devotshmëri të plotë si në gjërat e hapura edhe në të fshehtat.

3. Beso caktimin e Allahut, duke e ditur se Allahu është Ai që me të drejtë e meriton atë, pastaj kënaqu me caktimin e Tij.

4. Pastroje veprën tënde vetëm për Allahun, duke u larguar nga veprat jo për hir të Tij, ngase ato të çojnë në shirk.

5. Paso dhe mos shpik, pasi i Dërguari i Allahut duhet të jetë shembull në pasim për çdo vepër tënden.

6. Fillo nga veprat më të rëndësishme, puna e sotme ka përparësi para të nesërme, farzet kanë përparësi para nafilëve, shtyllat kanë përparësi para kushteve.

7. Të jesh përkujtues i librit të Allahut; lexoje, mëso je dhe medito duke e forcuar lidhjen tënde me Allahun dhe duke u larguar nga shkaqet e dështimit në suksesin tënd.

8. Mbështetu tek Allahu për të gjitha punët e tua.

9. Binde veten të kesh ambicie për suksese të larta me lejen e Allahut.

10. Ndrysho për të mirë duke larguar nga vejta jote bindjet negative dhe dyshimet epshore.

11. Binde veten se qëllimet e tua duhen forcuar dhe sqaruar çdo herë e më shumë.

12. Bëja obligim vetes hartimin e planeve të ndryshme të jetës tënde, largohu nga çrregullimet, respekto punën tënde në çdo vend dhe kohë.

13. Planet dhe projektet e tua shfaq i në praktikë, në gjëra që shihen, largohu nga shtyrja e gjërave.

14. Kujdesu të mos e humbësh kohën pa punuar, mundohu të përparosh çdo herë e më shumë drejt projekteve të tua qoftë edhe me një hap të vetëm sepse kush ecën, mbërrin te objektivi i tij.

15. Mos harro se veprat janë më të shumta se koha, prandaj fillo me atë që është më e dobishme, ngase të ndihmon në realizimin e aspiratave të tua.

16. Motoja jote të jetë shpejtimi dhe garimi në vepra të mira, ajo që ka kaluar nuk kthehet. Jeta është garë, prandaj mos e humb kohën në përtaci e shtyrje të punëve.

17. Kujdes nga koprracia e largët dhe nga harxhimet e shumta e pa nevojë.

18. Ushqe në shpirtin tënd dashurinë për të tjerët.

19. Kujdesu për bukurinë, pastërtinë, ngase këto kanë efekte pozitive në jetën dhe suksesin tënd, por duke mos shpenzuar shumë në to.

20. Mos ia ngulit vetes idenë se gjërat janë të vështira, por vepro dhe gjërat realizohen me lejen e Allahut.

Allahu na bëftë prej tyre!

Unejs Murati

RREGULLA TË RËNDËSISHME NË DAVET

Ne e kemi për obligim të përdorim butësinë kur thërrasim në Allahun azze ve xhel, aq sa është e mundur, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Oj Aishe! Me të vërtetë Allahu është i Butë dhe e do butësinë dhe Ai jep suksese me butësinë, atë që nuk e jep me vrazhdësi dhe me çdo gjë tjetër përveç saj.”

Si çdo adhurim tjetër fetar, edhe daveti ka rregullat e veta të bazuara në shpallje dhe në metodën e Pejgamberit tonë, pasi në këtë mënyrë ky lloj adhurimi është së pari i pranuar nga Allahu azze ve xhel dhe së dyti i jep sjell frytet e veta dhe suksesin me lejen e Allahut.

Pra, daveti për Allahun ka rregulla të cilat muslimani ambicioz për përmirësimin e njerëzve duhet t'i ndjekë. Ato rregulla janë të shumta, mirëpo në këtë numër të revistës kemi zgjedhur vetëm dy prej tyre, të cilat kanë shumë rëndësi dhe kanë të bëjnë me aktualitetin e sotëm, pasi po ndodh që muslimanët aktivistë janë neglizhent ndaj tyre së bashku me hoxhallarët.

Këto dy rregulla janë:

1- Përdorimi i butësisë gjatë thirrjes

2- Kufizimi i ndjenjave në pajtim me she-riatin dhe logjikën.

Këto dy rregulla i kemi nxjerrë nga libri “Zgjimi islam” i dijetarit të madh Muhammed Salih el-Uthejmin, Allahu e mëshiroftë.

Përdorimi i butësisë

Ne e kemi për obligim të përdorim butësinë kur thërrasim në Allahun azze ve xhel, aq sa është e mundur, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Oj Aishe! Me të vërtetë Allahu është i Butë dhe e do butësinë dhe Ai jep suksese me butësinë, atë që nuk e jep me vrazhdësi dhe me çdo gjë tjetër përveç saj.”^[1]

Allahu subhanehu ve teala e kishte begatuar të Dërguarin e Tij me butësi dhe e kishte bërë të butë me robërit e Allahut, siç ka thënë Allahu i Lartësuar në Kur'an: **“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.”** Alu Imran 159

Krahasojë njerëzit vetë lexues i nderuar: nëse dikush do të kishte folur për ndonjë çështje me ashpërsi, do ta vëreje se egoja jote do të kishte shtyrë që edhe ti të silleshe me të ashtu siç ai u soll me ty dhe kështu shejtani do të kishte bindur

[1] Trans Muslimi 2593

se ai person nuk ka për qëllim këshillimin tënd, por vetëm kritikimin tënd. E, kur njeriut ia merr mendja se dikush ka për qëllim vetëm kritikimin, atëherë nuk e merr në konsideratë udhëzimin e tij e as thirrjen e tij. Mirëpo nëse vjen dikush dhe flet me ty me butësi dhe të thotë: “Kjo vepër që po bën nuk është në rregull” dhe pasi e mbyll një derë të haramit dhe hap një tjetër hallall, në mënyrë që të ta lehtësojë, me këtë metodë butësie do të arrihet hajr i madh.

Kjo që po ju përmend është prej orientimit të Allahut subhanehu ve teala dhe prej udhëzimit të Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe gjithashtu prej rasteve që ka praktikuar edhe vetë Pejgamberi ynë.

Po ju sjell një shembull me fjalën e Allahut të Lartësuar: *“O besimtarë! Mos thoni: ‘Ra’ina’,”*^[2] por thoni: *“Undhurna!”* (*“Na shiko!”*) dhe *dëgjoni!*^[3]

Kur Allahu i ndali ata nga shqiptimi i një fraze, ua zëvendësoi atyre me një frazë tjetër dhe u tha: *“Mos thoni: ‘Ra’ina’,”*^[4] por thoni: *“Undhurna!-‘Na shiko!’ dhe dëgjoni!”*

Kështu vepro edhe ti, nëse ua mbyll njerëzve një derë në të cilën ua ka ndaluar Allahu hyrjen, hapja një derë tjetër të lejuar për ta sepse njerëzit nuk mund të rrinë pa lëvizur dhe e kanë të detyrueshme që të punojnë, siç transmetohet në hadith: *“Emrat më besnikë janë Harith dhe Hemmam”*.^[5]

Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e

ka ndjekur këtë metodë. Kur erdhën tek ai me ca hurma të mira, ai u tha: *“Çdo hurmë e Hajberit është kështu (e mirë)?!”* Ata thanë: *“Jo, mirëpo ne e marrim një sa’a nga kjo lloj hurme me dy sa’a^[6] të hurmës (më të dobët në kualitet) dhe dy sa’a me tri të llojit tjetër.”* Atëherë ai tha: *“Mos veproni kështu, por shisni një grumbull me dërhëmë e pastaj me ata dërhëmë blini llojin tjetër të hurmës.”*^[7] Kështu Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i udhëzoi ata në mënyrën e lejuar të shkëmbimit, që hurmën me kualitet më të dobët ta shesin me dërhëmë e pastaj ta blejnë të mirën po ashtu me dërhëmë. Pra, kur ua mbylli derën e ndaluar, ua hapi të lejuarën.

Kësisoj duhet të veprojë çdo thirrës në Allahun azze ve xhel: nëse ua përmend njerëzve një rrugë të ndaluar, duhet t’ua hapë atë që është e lejuar.

Secili prej nesh që mediton për udhëzimin pejgamberik, do të vërejë se si Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ishte i butë me ummetin e tij dhe shembulli më i dukshëm është tregimi i arabit që hyri në xhami dhe urinoi në një kënd të saj. Atëherë u ngritën njerëzit duke e qortuar sepse kishte bërë një gjest shumë të shëmtuar, mirëpo Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i ndali dhe ata heshtën. Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem urdhëroi që në vendin ku kishte urinuar ai të derdhej një kovë me ujë që të hiqej ndyrësira, pastaj e thirri arabin dhe i tha: “Këto xhami nuk janë vend i ndyrësirave dhe i

[2] Fjala ra’ina në shembullin e këtushëm në arabisht do të thotë “na dëgjo” ose “na shiko me respekt”, por në hebraishten arabe të shekullit të shtatë ishte sharje me kuptimin “O i keqi ynë”. Shih Kuranin e përkthyer nga Hasan Nahi, të botuar nga Instituti Shqiptar, fq. 86, Tiranë 2008.

[3] Bekare: 104.

[4] Fjala ra’ina në shembullin e këtushëm në arabisht do të thotë “na dëgjo” ose “na shiko me respekt”, por në hebraishten – arabe të shekullit të shtatë ishte sharje me kuptimin “O i keqi ynë”. Shih: Kuranin e përkthyer nga Hasan Nahi të botuar nga Instituti Shqiptar, fq. 86, Tiranë 2008.

[5] Transmeton Ahmedî (4/345), Ebu Davudi në kapitullin e edukatës (4950).

[6] Një sa’a peshon sa katër mudd dhe një mudd është sikur kur bashkon dy shuplakat e dorës të shtrira dhe i mbush me hurma ose diçka tjetër. Shënim i përkthyesit.

[7] Transmeton Buhariu, kaptina e shitblerjes nr. 2201, 2202 dhe e ka transmetuar edhe Muslimi në kaptinën el-musakat (nr. 1593).

mbeturinave, por janë ndërtuar për namaz, tekbiir dhe lexim të Kur'anit.”^[8]

Në musnedin e Imam Ahmedit me shtojcë thuhet se ky njeri tha: “O Allahu im! Më mëshiro mua dhe Muhamedin dhe askënd tjetër përveç nesh!”^[9]

Pse? Sepse Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u soll butë me të dhe e edukoi.

Prandaj ajo në të cilën i ftoj vëllezërit është që ta ndjekin këtë metodë në rrugën e Allahut edhe gjatë refuzimit të të këqijave ngase me anë të butësisë do të arrijnë atë që nuk mund ta arrijnë me anë të ashpërsisë.

2 - Kufizimi i ndjenjave me kërkesat e shariatit dhe arsyes

Intelektualët dhe aktivistët e bekuar duhet të kenë kujdes që të mos rrëzohen para emocioneve, të cilat i pengojnë nga arsyeja e shëndoshë dhe të ecurit sipas kërkesave të shariatit, sepse nëse emocionet nuk kufizohen sipas suazave të shariatit dhe arsyes, atëherë mund të jenë shkatërruese dhe sjellin pasoja më shumë se rezultate pozitive. Për këtë shkak, vizionet tona duhet të jenë largpamëse, porse me këtë nuk kam për qëllim që ne duhet të heshitim dhe të qëndrojmë duarkryq karshi së kotës apo ta përkrahim atë. Mirëpo qëllimi im është që të hyjmë në shtëpi nga dyert dhe të përpiqemi që me çdo mundësi të ndjekim rrugën e urtësisë gjatë largimit të së kotës dhe shfarosjes së saj. Ngase ndjekja e rrugës së urtësisë, edhe nëse është e stërzgatur, prapëseprapë e ka frytin dhe rezultatin të kënaqshëm për të gjithë.

Ndoshta xhelozia për fenë e fik flakën e

zjarrit, mirëpo jo edhe gacat e saj, të cilat sërish mund të ndezin zjarrin.

Për këtë arsye unë i nxis të gjithë vëllezërit e mi, të gjithë të rinjtë të cilët janë aktivë në davet dhe të gjithë intelektualët që të tregohen të pjekur dhe me largpamësi e arsye. Të gjithë ju duhet që sjelljet tuaja t'i kufizoni në suaza të shariatit. Duhet të mësojmë nga urtësitë e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në thirrjen e tij në Allahun dhe në ndryshimin e të këqijave, prandaj le ta marrim atë për mostër të mirë, sepse sa shëmbëlltyrë e mirë është i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Si përfundim po i drejtohem rinisë së zgjimit islam: Nëse dëshirojmë që të zgjojmë ummetin islam nga neglizhenca, atëherë patjetër duhet të ecim me hapa të sigurt mbi themele të forta stabile sepse ne dëshirojmë që hyqmeti të jetë i Allahut dhe që të forcohet feja e Allahut në tokën e Allahut mbi robërit e Tij. Ky është një qëllim i madh, mirëpo vetëm me emocione nuk realizohet, pasi gjithsesi emocionet tona duhet t'i kufizojmë në suaza të shariatit dhe arsyes.”

Këto ishin dy rregulla të rëndësishme në veprimtarinë fetare, të cilat i kemi parë të arsyeshme t'ua sjellim juve aktivistë e intelektualë fetarë në këtë numër të kësaj reviste të bekuar, ndërsa në numrat e ardhshëm do t'ju sjellim edhe disa rregulla të tjera të rëndësishme, të cilat sjellin fryte në këtë rrugë të bereqetshme inshallah. Allahu është dhënësi i sukseseve!

*Zgjedhi dhe përshtati:
Zejd Haziri*

[8] Transmeton Muslimi, kaptina e taharetit (285).

[9] Transmeton Ahmedi në Musned (2/503).



DISA GABIME NË EDUKIMIN E FËMIJËVE (III)

Fëmija ka edhe të mira, të cilat shumë prindër i harrojnë apo nuk dëshirojnë t'i përmendin si falënderim ndaj fëmijës.

1) Një gabim tjetër që e gjen te disa prindër është dallimi që bëjnë mes fëmijëve, pra kur prindi është më i ashpër me njërin fëmijë dhe nuk sillet mirë me të, kurse me tjetrin është më i drejtë. Ka prindër që bëjnë dallim me sjelljet ndaj fëmijës së parë dhe ndaj fëmijës së dytë. Qëllon që njërin fëmijë e përqafon, kurse tjetrin e lë anash ose kur blen ndonjë dhuratë, i blen vetëm njërit dhe jo tjetrit, ose njërit i blen diçka më të mirë e tjetrit më të keqe dhe kështu bën padrejtësi. Kur mungon drejtësia mes fëmijëve, aty do të mungojë edhe dashuria

mes prindit dhe fëmijës që i bëhet padrejtësi.

Pasojat: Bërja e dallimeve mes fëmijëve lë hapësirë që të krijohet zilia dhe urrejtja mes fëmijëve apo edhe mes prindit dhe fëmijës. Një gjë e tillë mund të ndikojë tepër negativisht tek fëmijët. “Çdo rob të cilin Allahu e ngarkoi me një obligim përgjegjës dhe ai vdes në atë ditë kur vdes edhe ai, ka vjedhur në udhëheqësinë e tij dhe ka mashtruar. Allahu i Madhëruar. do t’ia ndalojë atij hyrjen në xhenet.” [1]

Këtë e ka thënë i Dërguari ynë sal-lAllahu

[1] Sahihul Buhari 112/13 dhe Muslimi 142

alejhi ve sel-lem, prandaj kini kujdes se pasojat janë tepër të mëdha.

Përmirësimi: Prindi duhet të jetë shumë vigjilent dhe i kujdesshëm ndaj fëmijëve. Ai duhet të mbajë drejtësi si në blerje, edhe në dashurinë që u dhuron fëmijëve. Resullallahu sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na ka urdhëruar që të tregohemi të drejtë mes fëmijëve kur u japim atyre diçka. Ai thotë: *“Kur t’u jepni atyre, jini të drejtë.”*

2) Prindërit i dinë edhe të mirat edhe të këqijat e fëmijëve të tyre, mirëpo jo të gjithë prindërve u bie në mend t’ua përmendin edhe të mirat ashtu siç përmendin të këqijat. Shumë prindër përmendin vetëm veprat e këqija të fëmijës. Edhe pse mundohen të flasin në mënyrë këshilluese, ata vazhdimisht vetëm qortojnë duke i thënë fëmijës përse e bëre këtë, sa keq e bëre atë, nuk dije më mirë, ti nuk di asgjë, nuk je i hajrit, ti s’do vësh mend kurrë dhe fjalë të tjera që ndikojnë te fëmija për të keq. Fëmija ka edhe të mira, të cilat shumë prindër i harrojnë apo nuk dëshirojnë t’i përmendin si falënderim ndaj fëmijës.

Pasojat: Mund të mendoni që kjo veprë s’ka pasoja të mëdha apo s’ka fare. Ky mendim është i gabuar, ngase pasojat nga mosrespektimi për veprat e mira që bën fëmija shkaktojnë që fëmija t’i lërë ato, pasi e sheh që këto të mira, si i bëri si nuk i bëri, nuk paskan dobi për askënd, ngase askush nuk i tha që është duke bërë mirë. Po ashtu, në vend që t’i shtohet dashuria ndaj prindërit, ajo nuk lëviz dhe ndoshta

edhe pakësohet duke e ndier mungesën e respektit nga ana e prindërve për veprat e mira që ai bën.

Fëmijës do t’i humbë apo do t’i dobësohet vetëbesimi dhe do të ndihet tepër i pavlerë. Pa dyshim që kjo e shton edhe pikëllimin tek fëmija.

Përmirësimi: Kur bën një punë të mirë, fëmija duhet falënderuar ose përgëzuar se sa mirë ka vepruar, se kështu fëmija do të ndiejë kënaqësi në vetvete që prindi është i kënaqur me veprat e tij. Kush nuk gëzohet kur dikush i përmend një veprë të tij të mirë? Kështu shtohet edhe dashuria sepse gëzimi ndaj një të mirë që dikush të bën apo një falënderim, të shton dashurinë ndaj tjetrit. Përmendini veprat e mira të fëmijës dhe pastaj, nëse doni ta këshilloni për veprat jo të pëlqyera, atëherë përmendini mbasi t’i keni përmendur të mirat. Me këtë veprë do të fitoni edhe dashurinë e fëmijës, edhe respektin po ashtu edhe këshillimi do ketë efekt më të madh.

3) Shumë prindër harrojnë të kalojnë kohë së bashku me fëmijët e tyre. Koha sot ka ndryshuar nga ajo që ishte disa vite më parë. Më parë familjet ishin më të mëdha dhe të gjithë kishin kënaqësi të rrinin bashkë. Kurse tani shumë familje rrinë të zbrazura deri kur vjen nata për të fjetur. Në shtëpi nuk është babai ngase qëndron në punë deri orët e vona ose punon mbas orarit, edhe nëna gjithashtu punon. As-



njëri nga prindërit nuk gjen kohë për fëmijët e vet. Fëmijët mbas shkolle qëndrojnë vetëm në shtëpi duke shikuar televizor, duke shëtitur nëpër rrugë ose shoqërohen me ndonjë shok apo shoqe për të cilët prindërit nuk dinë asgjë. Po ç'ndodh kur fëmija ka nevojë që dikush ta ndihmojë për detyrat e shkollës? Gjendjen e sotme shumë njerëz e mendojnë si "jetë të mirë dhe moderne", mirëpo nuk po mendojnë pasojat që vijnë më pas. Për t'u shtuar dashuria në një familje mes prindërve dhe fëmijës është e domosdoshme që ata të kalojnë kohë së bashku.

Pasojat: Ky gabim i madh i shumë prindërve, sidomos i atyre që sot jetojnë në shtetet perëndimore, nuk shihet fare si gabim. Fëmijët mbeten vetëm dhe humbin dashurinë dhe afërsinë ndaj prindërve. Ata humbin edhe marrëdhëniet e mira ndaj farefisit e ndoshta kalon një kohë tepër e gjatë dhe nuk takohen me ta, për të mos thënë që fëmijët ndoshta as nuk arrijnë t'i njohin të afërmit. Fëmijët e ndiejnë që askush nuk mendon për ata dhe ndihen tepër të lënë pas dore. Kështu fëmija mund të bjerë në depresion dhe të distancohet edhe nga shoqëria në shkollë. Po ashtu mund të ndodhë që fëmija të dalë në rrugë dhe të takohet me shoqëri të gabuar, duke i hyrë rrugës së veprave të këqija dhe të fëlliqura. Fëmija do të vazhdojë të kërkojë zbavitje apo kënaqësi në gjërat jashtë shtëpisë ngase i mungon dashuria dhe aktivitetet e ndryshme me familjen e vet.

Ky gabim ka shumë pasoja, varësisht ku fëmija gjendet vetëm kur prindi nuk është në shtëpi. Mirëpo pasojat e përbashkëta të këtij gabimi janë dëshpërimi, vetmia, humbja e dashurisë dhe afërsisë së prin-

dërve dhe farefisit dhe shkakun që fëmija të shkojë drejt së keqes.

Përmirësimi: Është mirë që të kaloni më shumë kohë me familjen sesa me shoqërinë apo në ndonjë punë tjetër. Duhet të gjeni kohë edhe për fëmijët, edhe pse punoni dhe keni shumë obligime. Por mos harroni se obligim i madh është edhe familja.

Gjetja e kohës për familjen jo vetëm që do të shtojë dashurinë mes prindit dhe fëmijës, mirëpo është edhe sunnet. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjithmonë ka gjetur kohë për familjen e tij dhe ka qenë më i miri me të. Prandaj prindi duhet të sillet me fëmijët e vet ashtu si ka vepruar Resulullahu sal-lallahu alejhi ve sel-lem me fëmijët dhe nipat e tij. Sahabët na transmetojnë se Resulullahu i merrte në krah Hasanin dhe Husejnin e nganjëherë ata i hipnin në shpinë e ai lozte me ta. Ka pasur edhe raste kur ata kanë qenë në krahun e Resulullahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe kanë kryer edhe nevojën e tyre.

4) Mungesa e rutinës

1. Shumë shpesh shohim fëmijë që nuk njohin kufij dhe nuk dinë t'u përmbahen urdhrave të prindërve. Nuk është për t'u habitur me këta fëmijë sepse që në fillim nuk kanë mësuar se jeta ka rregulla, zyrtare dhe jozyrtare. Prindërit e tyre i kanë ndaluar ata nga e keqja me një edukatë tepër të gabuar. Ata nuk u kanë vendosur fëmijëve rregulla që t'u përmbahen, pastaj edukimi i fëmijës është bërë edhe më vështirë për prindin. Prindërit nuk kanë vendosur rregulla së bashku me fëmijën, që familja të ketë disiplinë.

Pasojat: Pa rregulla fëmijët s'do dinë se cilët janë kufijtë dhe cili është roli i tyre në

familje. Pa rregulla do funksionojë çdo gjë me vështirësi. Nëse s'ka rregulla, fëmija do ta presë çdo gjë gati duke mos mësuar për përgjegjësinë e vet.

Përmirësimi: Çdo familje duhet të ketë rregulla, të shkruara apo të pashkruara. Është mirë që prindërit së bashku me fëmijët të diskutojnë si t'i ndajnë punët, që të gjithë të jenë të kënaqur. Këto rregulla e ndihmojnë familjen të funksionojë me harmoni. Përmes rregullave fëmijët fitojnë siguri dhe kjo ndihmon që anëtarët e familjes t'i respektojnë nevojat e njëri-tjetrit. Rregullat sigurojnë që puna në shtëpi të jetë e ndarë baras për të gjithë. Këto rregulla i ndien edhe fëmija pozitivisht, pikërisht sepse e di çfarë pritet nga ai.

Fëmija nuk mund t'u përmbahet shumë rregullave menjëherë. Është më mirë që mos të ketë më shumë se 5-6 rregulla në të njëjtën kohë. Këto duhet të jenë tepër të qarta dhe fëmijët duhet t'i njohin ato, duke ua shpjeguar prindi më parë. Fëmijët kështu i rregullojnë edhe sjelljet e tyre dhe mësohen të jenë të ndërgjegjshëm.

2. Asgjë nuk e ka kohën apo kufizimin e vet sepse prindërit nuk dinë të paraqesin kufij. Ka fëmijë që bien herët në gjumë, hanë bukë në kohën e duhur, shikojnë televizor në një orë të caktuar, që dalin e shëtisin me kohë etj. Mirëpo janë shumë të paktë, më shumë ka fëmijë që nuk flenë deri vonë dhe prindi ka vështirësi t'i urdhërojë për në gjumë. Prindi lodhet duke e urdhëruar fëmijën më shumë se pesë herë që të bjerë në gjumë, por fëmija assesi nuk shkon duke u arsyetuar me fjalët "ja tani", "edhe pak", "pse ju nuk flini". Mbas këtyre fjalëve nuk bie në gjumë dhe rri zgjuar deri vonë. Ka më shumë fëmijë që nuk duanë të hanë bukë kur nëna e ka shtruar bukën

për të gjithë. Ata fëmijë arsyetohen se nuk janë të uritur apo janë të zënë etj. Po ashtu edhe shikimi i televizorit dhe qëndrimi para kompjuterit është bërë problemi i madh me fëmijët. Prindërit gabojnë duke mos u caktuar orar dhe rutinë.

Pasojat: Fëmija arsyetohet vazhdimisht për gjërat që s'kanë rutinë dhe orar, duke vazhduar prapë me sjelljet e tij. Prindi humb autoritetin e vet, humb forcën si prind dhe dëshpërohet. Kjo pasoje bie edhe tek prindi edhe tek fëmija. Të prindi bie ngase nuk dëgjon fëmija e kjo është një barrë e madhe për prindër. Kurse për fëmijën gjërat pa rutinë s'kanë kufij dhe vazhdojnë pa u ndalur me pasoja, për shembull ai shkatërron sytë me shikimin e tepërt të televizorit apo me qëndrimin para kompjuterit.

Përmirësimi: Prindi duhet të vendosë rregulla për fëmijët dhe në përgjithësi për familjen, duke treguar qartë se për shembull në drekë do të ulen të gjithë për të ngrënë; nëse jo, atëherë nuk ka bukë deri në mbrëmje. Dhe prindi nuk duhet të harrojë ta mbajë këtë fjalë, sepse përndryshe nuk do ketë vlerë fjala dhe fëmija do të vazhdojë të hajë kur të dojë dhe jo kur ulen për të ngrënë të gjithë.

Rutina duhet të vlejë për të gjithë anëtarët në familje, sepse sikur ta thyejë një rregull prindi, edhe fëmija do ta thyejë. Rutina është tepër e mirë sepse ndihmon edhe në mësimin e pesë kohëve të namazit, pasi fëmija do të mësohet që pesë herë në ditë e ka për obligim të falet.

Vijon

Laura Ferati, Norvegji

THIRRJE

PËR VËLLËZËRIT DHE MOTRAT E BESIMIT PËR ARDHJEN E MUAJIT TË AGJËRIMIT

AI ËSHTË MUAJI I FRIKËS DHE SHPRESËS, JO I FJALËVE TË TURPSHME DHE ZHURMAVE.

Mes nesh dhe muajit të agjërimit mbeten vetëm disa ditë dhe orë.

T'i shijojmë këto momente dhe orë,
Sepse mund të jetë ky viti i fundit për ne.

Ai është muaji i agjërimit dhe faljes,

Muaji i sinqeritetit dhe besimit.

Muaji i shpejtimit për të mira.

Ai është muaji i përmendjes së Allahut dhe Kuranit,

Muaji kur prangosen shejtanët.

Ai është muaji i përmirësimit dhe vetëllogaritjes,

Muaji kur hapen dyert e xhennetit dhe mbylleen dyert e xhehenemit.

Ai është muaji i ndërmjetësimit dhe i xhennetit Rejjan,

Muaji i kujdesit nga padrejtësitë dhe nga veset.

Ai është muaji i frikës dhe shpresës, jo i fjalëve të turpshme dhe zhurmave.

Ai është muaji i sinqeritetit dhe ndershmërisë,

Muaji i xhennetit dhe ruajtjes nga zjarri.

Ai është muaji i kohës së pushimit dhe lutjes,

Muaji i largimit nga zjarri.

Ai është muaji i reformës dhe pajtimit.

Muaji i durimit dhe dhënies.

Ai është muaji i pranimit të së mirës dhe largimit nga e keqja,

Muaji i nxitjes për të mira dhe garës në lëmoshëdhënie.

Ai është muaji i shlyerjes dhe faljes së mëkat-

eve, ruajtës nga devijimet,

Muaji i përmirësimit të fjalës, ruajtjes së gjymtyrëve dhe veprimit të veprave të këqija.

Ai është muaji i mirëmbajtjes së zemrës dhe gjuhës,

Muaji që mbulon shpirtrat dhe triumfon epshtet.

Ai është muaji i gëzimit dhe respektit, bindjes dhe përforcimit,

Muaji i largimit nga fjalët e liga dhe përdorimi i tyre.

Ai është muaji i të mirave, përqafimit të tyre dhe thirrjes për te to,

Muaji i qetësisë, i pendimit dhe faljes, i pranimit të realitetit dhe i kthimit në të.

Pra, të përgatisim shpirtrat tanë,

...të ndalim lapsat tanë,

...të ndërpresim lëvizjet e gjuhëve tona,

...të vrojtojmë lëvizjet e lapsave dhe këmbëve tona.

Fitues është ai që e përqafon këtë muaj në të gjitha punët e mira.

Humbës është ai që pason epshtet dhe shejtanin.

O Allah, na bëj përqafues të së mirave dhe të larguar nga të këqijat!

Ali ibën Hasen el Halebi

<http://www.kulalsalafiyeen.com/vb/>

Përshtati: Unejs Murati

VLERA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT DHE E NAMAZIT TË TERAVISË SI DHE SQARIMI I DISA DISPOZITAVE TË CILAT MUND TË MOS I NJOHIN DISA NJERËZ



“Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu) i falen gjynahet që ka bërë. Ai që fal namazin e natës gjatë Ramazanit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë. Ai që fal namazin e natës Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë.”

Kjo është një këshillë e shkurtër, që ka të bëjë me agjërimin e Ramazanit, namazin e taravisë, me vlerën e konkurrencës në punë të mira gjatë këtij muaji, por njëkohësisht sqaron edhe disa dispozita shumë të rëndësishme, të cilat mund të mos i njohin disa njerëz. Është saktësuar se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i përgëzonte shokët e tij për ardhjen e këtij muaji. I njoftonte se në këtë muaj hapen portat e mëshirës dhe të xhenetit dhe mbyllen portat e xhehenemit dhe prangosen djajtë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Në natën e parë të Ramazanit hapen portat e xhenetit dhe nuk mbetet asnjë portë e mbyllur dhe mbyllen portat e xhehenemit dhe asnjëra prej tyre nuk mbetet e hapur. Prangosen djajtë dhe një thirrës thërret: “O ti që synon të

mirën (shpërblimin), angazhohu në punë të mira! O ti që ke ndërmend të kryesh mëkate, tërhiq!” Dhe për çdo natë Allahu liron (shumë persona) nga zjarri.” [1] Po ashtu, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Ju erdhi muaji i Ramazanit, muaji i begatise. Në këtë muaj Allahu ju mbulon me mëshirën e Tij, ju shlyen mëkatet dhe u përgjigjet lutjeve. Allahu shikon se si ju garoni në këtë muaj dhe krenohet me ju para melekëve. Shfaqini Allahut vetëm punë të mira, sepse vërtet i mjerë është ai që në këtë muaj i mohohet mëshira.” [2] Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë. Ai që fal namazin e natës gjatë Ramazanit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka

[1] Tirmidhiu 682

[2] Hejthemiu në 'Mexhma Ezzeuaid' (3/142) thotë se e transmeton Tabaraniu në El Kebir.

bërë. Ai që fal namazin e natës Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë.”^[3]

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “*Al-lahu i Lartësuar ka thënë: “Çdo vepër që kryen biri i Ademit është për të dhe çdo vepër e mirë i shpërblehet me dhjetë të mira deri në shtatëqind, përveç agjërimit, sepse agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të, ai largohet prej kënaqësive dhe ngrënies për Mua. Për agjëruenin ka dy gëzime, një kur ha iftarin dhe tjetri kur të takojë Zotin e tij. Era e gojës së agjëruenit tek Allahu është më e mirë se era e miskut.”*^[4] Hadithet që flasin për vlerën e agjërimit të Ramazanit, namazit dhe agjërimit në përgjithësi janë të shumta. Mirësinë e Allahut për mbërritjen e muajit të Ramazanit, besimtari duhet ta shfrytëzojë për t’i intensifikuar përpjekjet e tij në kryerjen e sa më shumë veprave të mira dhe largimin nga mëkatet. T’i kryejë të gjitha detyrimet ndaj Allahut, sidomos pesë namazet, sepse namazi është shtylla e fesë dhe detyrimi më madhor pas shehadeetit. Pra, është detyrim për çdo besimtar/besimtare që ta ruajë namazin dhe ta falë në kohën e vet me përkushtim (i përlulur) dhe tumanine (qetësimi në ruku, në këmbë pas ngritjes nga rukuja, në sexhde dhe në uljen mes dy sexhdeve). Prej detyrimeve më të rëndësishme për burrat është falja e tij me xhemat në xhami, ndërtimin e të cilave e ka urdhëruar Allahu në mënyrë që të përmendet emri i Tij, siç thotë Allahu i Madhërishtëm: “*Faleni namazin, jepni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen (në namaz).*” (El Bekare, 43) “*Faleni rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij.*” Bekare, 238 “*Me të vërtetë të shpëtuar janë besimtarët e përlulur në namazin e tyre, deri të fjalët e Tij: “dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet. Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.*” Mu’minun, 1-2, 8-11

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë:

“*Marrëveshja mes nesh dhe atyre (jobesimtarëve) është namazi, kështu që kush e lë namazin ka bërë kufër.*”^[5] Prej detyrimeve më të rëndësishme pas namazit është dhënia e zekatit. Allahu i Lartësuar thotë: “*E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.*” Bejjine, 5 “*Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!*” Nur, 56. Është vërtetuar me Kuranin e Madhërishtëm dhe me Sunnetin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ai që nuk e paguan zekatin e pasurisë së tij do të dënohet me të Ditën e Kiametit. Më tej, prej çështjeve më të rëndësishme pas namazit dhe zekatit është agjërimi i muajit të Ramazanit, i cili është prej pesë shtyllave të përmendura në fjalët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “*Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshminë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) është i Dërguar i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e Ramazanit dhe kryerjen e haxhit.*”^[6] Është obligim që besimtari ta ruajë agjërimin dhe namazin e tij nga të gjitha ato fjalë e vepra të cilat i ka ndaluar Allahu i Lartësuar, sepse me agjërim synohet bindja ndaj Allahut, respektimi i ndalesave të Tij, lufta ndaj vetvetes për mposhtjen e epsheve dhe nënshtrimin ndaj Allahut si dhe kalitja e vetvetes me durim në respektimin e ndalesave të Allahut. Nuk është qëllimi i agjërimit vetëm largimi nga ngrënia dhe pija dhe gjërat e tjera të cilat e prishin agjërimin. Për këtë është saktësuar se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “*Agjërimi është mburojë dhe nëse ndonjëri është agjërueshëm, të mos flasë fjalë të ndyta dhe të mos jetë i bezdisshëm. Nëse ndokush e fjen agjëruenin ose e godet, le të thotë: “Unë jam agjërueshëm.”*^[7] Gjithashtu është saktësuar se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “*Al-lahu i Madhëruar nuk ka nevojë për agjërimin e*

[3] Buhariu 2014, Muslimi 760

[4] Buhariu 1904 dhe Muslimi 1151

[5] Ahmedi 22428, Termidhiu 2621 dhe Ibën Maxhe 1079.

[6] Buhariu 8, Muslimi 16

[7] Buhariu 1904

dikujt që lë ushqimin dhe pirjen dhe nuk braktis fjalët e këqija (gënjeshttrat) dhe të vepruarit me to dhe injorancën.”^[8]

Prej këtyre citateve dhe të tjerave si këto kuptojmë se është detyrë për agjëruenin t’i shmanget çdo gjëje që ka ndaluar Allahu dhe të zbatojë çdo detyrim ndaj Tij. Me këtë shpresohet se ai do të falet, do të lirohet prej zjarrit dhe t’i pranohet agjërimi bashkë me namazin. Ka disa çështje të cilat mund t’u shpëtojnë disa njerëzve pa i njohur. Është obligim që besimtari të agjërojë duke qenë i bindur se agjërimi është farz (obligim prej Allahut) dhe duke shpresuar në shpërblimin e Allahut. Nuk duhet të agjërojë për sy e faqe apo për t’u lavdëruar para të tjerëve. Nuk duhet të agjërojë sepse njerëzit e tjerë agjërojnë, ose duke ndjekur njerëzit e vendit të vet. Pra, vetëm besimi se Allahu e ka obliguar agjërimin dhe shpërblimi që do të marrë tek Allahu duhet të jenë motivi ynë për të agjëruar. Edhe faljen gjatë muajit të Ramazanit duhet ta kryejë me besim dhe duke shpresuar në shpërblimin e Allahut. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu) i falen gjynahet që ka bërë. Ai që fal namazin e natës gjatë Ramazanit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë. Ai që fal namazin e natës Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë.” Prej dispozitave që mund të mos i njohin disa njerëz janë edhe rastet kur njeriu mund të pësojë ndonjë plagë, mund të ketë hemorragji nga hundët, të vjella (gjatë punës) pa dashje. Të gjitha këto nuk e prishin agjërimin, por nëse vjell qëllimisht, agjërimi i tij prishet bazuar në fjalët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “*Për secilin që e kaplon vjellja nuk ka kompensim, ndërsa ai që vjell me vetëdëshirë duhet ta kompensojë.*”^[9]

Njeriut mund t’i ndodhë ta vonojë pastrimin nga xhunubllëku deri në agim, po ashtu edhe gruaja guslin nga menstruacionet ose lehonja, mirëpo

nëse vëren se është e pastër para agimit, ajo obligohet të agjërojë. S’prish punë nëse e vonon guslin edhe deri pas agimit, por nuk i lejohet asaj ta vonojë deri pas lindjes së diellit. Me një fjalë, ajo detyrohet të pastrohet dhe të falë namazin e sabahut para lindjes së diellit. Sa i takon burrit, ai duhet të kujdeset, madje edhe ta arrijë faljen e namazit të sabahut me xhemat. Dhënia e gjakut për analiza, marrja e injeksionit, përveç atij që është ushqyes, nuk e prishin agjërimin, por vonimi i këtyre nëse është e mundur deri pas iftarit është më e pëlqyer. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “*Atë në të cilën ke dyshim zëvendësoje me diçka në të cilën nuk ke dyshim.*”^[10] “*Ai që ruhet nga dyshimet, e ka ruajtur (mbrojtur) fenë dhe nderin e tij.*”^[11]

Prej dispozitave që mund të mos i njohin disa njerëz është edhe mosqetësimi në namaz, si në namazet farz ashtu edhe në ato sunnet. Në shumë hadithe të sakta theksohet se tumaninia është kusht prej kushteve të namazit, pa të cilin namazi nuk është i vlefshëm.

Me tumanine nënkuptojmë përqendrimin dhe mosngutjen derisa çdo pjesë (vertebër) të marrë pozicionin e vet. Shumë njerëz namazin e taravisë e falin duke mos qenë të vëmendshëm, duke mos u qetësuar në pozicionet e caktuara dhe nxitimthi ashtu si zogu çukurit. Ky namaz është i kotë (i papranuar) dhe falësi i namazit në këtë mënyrë është mëkatar dhe nuk merr shpërblim. Prej dispozitave që gjithashtu mund të mos i dinë disa njerëz është edhe gjykimi i gabuar i disave se namazi i taravisë nuk bën të falet në më pak se njëzet rekate apo me më shumë se njëmbëdhjetë ose trembëdhjetë rekate. Pra, ky është mendim i gabuar që bie ndesh me argumentet. Hadithe të vërteta nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dëshmojnë se namazi i natës është i pakufizuar dhe nuk ka ndonjë numër të caktuar që nuk guxon të kundërshtohet. Madje është saktësuar se ai falte gjatë natës njëmbëdhjetë rekate, nganjëherë edhe trembëdhjetë.

[8] Buhariu 1903

[9] Ibën Maxhe 1676

[10] Nesaiu 5711

[11] Buhariu 52, Muslimi 1599

Mund të ketë falur madje edhe më pak se kaq, si në Ramazan ashtu edhe jashtë tij. Kur është pyetur në lidhje me namazin e natës, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem tha: *“Namazi i natës falet dy nga dy, por nëse dikush frikësohet nga hyrja e sabahut, të falë një rekat me të cilin e përmbyll namazin që ka falur.”*^[12]

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem nuk ka përcaktuar numër të kufizuar rekatesh, as për faljen gjatë Ramazanit dhe as jashtë tij. Për këtë arsye, në kohën e sahabëve, konkretisht në kohën e Umerit radiallahu anhu, në disa raste faleshin njëzet e tre rekate, në disa të tjera njëmbëdhjetë. E gjithë kjo është saktësuar nga Umeri radiallahu anhu dhe nga sahabët gjatë kohës së tij. Disa prej selefëve gjatë Ramazanit falnin tridhjetë e gjashtë rekate, ndërsa vitrin e falnin me tre rekate. Disa e falnin namazin e teravisë me dyzet e një rekate. Të gjitha këto i ka transmetuar prej tyre Shejhul Islam ibën Tejmiye dhe dijetarë të tjerë. Po ashtu, ai ka theksuar se në këtë çështje nuk jemi të kufizuar, ndërkohë që ka përmendur se është më mirë të zgjatet leximi, rukuja dhe sexhdja si dhe të pakësohen rekartet. Ndërsa për atë që lexon më pak dhe e bën rukunë dhe sexhden më të shkurtër, për të është më mirë të falë më shumë rekate.

Por duhet thënë se ai që mediton për Sunnetin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e kupton se më e mira nga të gjitha këto është falja me njëmbëdhjetë ose trembëdhjetë rekate si gjatë Ramazanit ashtu edhe jashtë tij, sepse kjo formë përshtatet me veprimin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem në shumicën e rasteve dhe për faktin se është më e lehtë për falësit dhe më afër përqendrimit dhe tumaninës. Por nëse dikush shton më shumë, nuk prish punë dhe nuk është e papëlqyer.

Për atë që falet pas imamit është më e pëlqyer që namazin ta përfundojë me imamin sepse Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Nëse njeriu falet me imamin derisa të përfundojë, vërtet që atij i shkruhet sikur të jetë falur gjatë gjithë natës.”*^[13]

[12] Buhariu 991, Muslimi 749

[13] Tirmidhiu 806

[14] Ibën Huzejme në 'Sahih' nr. 1887. Albani e ka vlerësuar të dobët në librin e tij 'Eddaifeh vel Mevdua 2/263

[15] Buhariu 1863, Muslimi 1256

Rekomandohet për çdo besimtar që gjatë këtij muaji fisnik të angazhohet në kryerjen e sa më shumë adhurimeve: të falë sa më shumë namaze nafile, të lexojë Kuran dhe të meditojë në ajetet e tij, të bëjë sa më shumë tespihe (subhanallah), tehlile (la ilahe illallah), tahmide (elhamdulillah) dhe tekbire (Allahu ekber), të kërkojë falje sa më shumë, të lutet sa më shumë, të thërrasë në të mirë dhe të ndalojë nga të këqijat, të thërrasë në rrugën e Allahut, t'i ndihmojë të varfrit, ta shtojë mirësjelljen dhe kujdesjen ndaj prindërve, t'i forcojë lidhjet me të afërmit, të respektojë fqinjët, të vizitojë të sëmurët si dhe të tjera punë të ngjashme. Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Allahu shikon se si ju garoni në këtë muaj dhe krenohet me ju para melekëve. Shfaqini Allahut vetëm punë të mira sepse vërtet është i mjerë ai të cilin në këtë muaj i mohohet mëshira.”* Po ashtu transmetohet të ketë thënë: *“Kushdo që i afrohet Allahut me një vepër të mirë në këtë muaj është si të ketë kryer një farz në muajt e tjerë, ndërsa kush e kryen një farz në këtë muaj është si të ketë kryer shtatëdhjetë farze në muajt e tjerë.”*^[14] Po ashtu thotë: *“Një umre e kryer në Ramazan ka vlerën e një haxhi.”* Në një transmetim tjetër: *“Sa një haxh i kryer me mua.”*^[15]

Siç u theksua edhe më parë, janë transmetuar shumë hadithe të cilat na nxisin t'i intensifikojmë përpjekjet tona për ta shtuar rivalitetin dhe për të kryer sa më shumë vepra të mira në këtë muaj fisnik.

E lus Allahun e Lartësuar të na japë sukses neve dhe gjithë besimtarëve në çdo punë me të cilën Ai është i kënaqur, ta pranojë agjërimin dhe faljen tonë, ta përmirësojë gjendjen tonë dhe të na ruajë nga çdo sprovë që mund të na lëkundë. Gjithashtu e lus Allahun që t'i përmirësojë udhëheqësit e muslimanëve dhe t'i bashkojë ata rreth së vërtetës.

*Abdulaziz ibën Baz
Përshtati: Blerim Kransiqi*



SË PARI DUHET OFRUAR

Islami

"Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu çdo populli ua hijeshuam-zbukuruam veprat e tyre." En'am 108

Pyetje: Shumë të rinj janë të hutuar e nuk dinë si të ballafaqohen me të këqijat e shfaqura në shumë vende islame: a të ballafaqohen me to me ashpërsi, siç veprojnë disa të rinj, apo të ballafaqohen me ndonjë formë tjetër? Ata nuk e gjejnë përgjigjen e duhur në disa vende islame, të cilat nuk gjykojnë me sheriatin e Allahut sipas metodës së duhur. Cili është mendimi juaj, i nderuari hoxhë, për udhëzimin e këtyre të rinjve?

Përgjigja: Mendimi im është që të fillojnë me ofrimin e Islamit të mirëfilltë, me besimet që përmban Islami, veprat dhe morallet e tij dhe mos t'i sulmojnë njerëzit me një sulm që shkakton largimin e tyre. Unë jam i bindur se nëse Islami u paraqitet dhe u ofrohet njerëzve ashtu siç duhet, natyrshtëria e tyre do ta pranojë pa marrë

parasysh se si është çështja, sepse feja islame është në pajtim me natyrshmërinë e pastër. Sulmi kundër tjetrit për gjendjen e kaluar të tij, të prindërve apo të gjyshërve të tij sjell vetëm largim dhe urrejtje ndaj së vërtetës, prandaj Allahu i Lartësuar thotë: *"Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu çdo populli ua hijeshuam-zbukuruam veprat e tyre."* En'am 108

Për këtë arsye, i këshilloj vëllezërit davetxhi që në shoqëri të tilla të kenë kujdes në sqarimin e së vërtetës siç duhet e gjithashtu ta sqarojnë të kotën siç duhet, duke mos u ndeshur direkt me ta në veprat e tyre.^[1]

*Përshtati:
Namik Vehapi*

[1] Kjo fetva është marrë nga libri "Es-sahvetul islamiye davabit ve teuxhihat", fq. 69, i shejhut të nderuar Muhamed ibën Salih el-Uthejmin, Allahu e mëshiroftë!